



inject
Initiative for
Justice and Equality

Dhuna ekonomike shkelë të drejtën themelore të njeriut në pronë



© Initiative for Justice and Equality INJECT, 2021

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Autor: Diellza Mujaj
Redaktoj: Luljeta Aliu

Ky hulumtim është zhvilluar në kuadër të angazhimit të INJECT për rregullimin ligjor të dhunës ekonomike, me qëllim që të mbështesë punën e akterëve të kyçur në procesin e ndryshimit të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Ndryshimet në këtë ligj janë inicuar në vitin 2018, me kërkesën e INJECT dërguar Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Publikimi mbështetet nga Projekti HumanRightivism i zbatuar nga Fondi i Zhvillimit të Komunitetit (CDF) dhe financuar nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit për Zhvillim Ndërkombëtar.

Deklaratë mohimi:

Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë raport janë nga INJECT. Ato nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare ose pozicionin e SIDA-s, apo të Qeverisë së Suedisë.

**DHUNA EKONOMIKE
SHKELË TË DREJTËN THEMELORE
TË NJERIUT NË PRONË**

Prishtinë, Kosovë
Qershor 2021

Përmboajtja

HYRJE	9
1. E DREJTA NË PRONË	10
1.1 Lindja e të drejtës në pronë: nga prona publike te prona private	10
1.2 Koncepti modern i të drejtës në pronë	10
1.2.1 Instrumentet Ndërkombëtare	10
1.2.2 Instrumentet rajonale	11
1.3 Objekti i të drejtës në pronë	11
1.4 E drejta në pronë dhe ndërlidhmëria me të drejtat e tjera themelore	12
1.4.1 E drejta në pronë dhe të drejtat civile dhe politike	12
1.4.2 E Drejta në pronë dhe të drejtat socio-ekonomike	13
1.5 Obligimet e shtetit kundrejt të drejtës në pronë	13
1.6 Të Drejtat Pronësore në kontekstin kosovar	13
2. DHUNA EKONOMIKE	14
2.1 Definimi i dhunës ekonomike	14
2.2 Në çfarë formash manifestohet dhuna ekonomike?	15
2.2.1 Kufizimi i qasjes në para	15
2.2.2 Monitorimi i detajuar i shpenzimeve të partneres	16
2.2.3 Marrja e njëanshme e vendimeve të rëndësishme financiare	16
2.2.4 Refuzimi për të kontribuar në shpenzimet familjare	16
2.2.5 Eksploatimi i resurseve	17
2.2.5.1 Nga partneri	17
2.2.5.2 Nga anëtarët e familjes së tij	17
2.2.5.3 Eksploatimi i të moshuarave	17
2.2.6 Vjedhja dhe dëmtimi i pasurisë së partneres	18
2.2.7 Hyrja në kredi në emër të partneres	18
2.2.8 Pengimi i punësimit dhe ngritjes në detyrë	18
2.3 Dhuna ekonomike gjatë dhe pas divorcit	19
2.4 Cilët janë shkaktarët e dhunës ekonomike?	19

2.4.1 Mentaliteti	19
2.4.2 Historia e mëparshme e dhunës në familje	20
2.4.2 Niveli i arsimimit dhe puna	20
2.4.3 Mungesa e njohurive rreth dhunës ekonomike	20
2.4.4 Kushtet e rënda ekonomike/varësia financiare	20
2.5 Ndërlidhja e dhunës ekonomike me format e tjera të dhunës	21
2.6 Pasojat	21
3. ADRESIMI I DHUNËS EKONOMIKE NË SHITETET E JASHTME	23
3.1 Australia	23
3.2 Mbretëria e Bashkuar	24
3.3 India	24
3.4 Praktika Gjyqësore	25
4. DHUNA EKONOMIKE NË KONTEKSTIN KOSOVAR	25
4.1 Identifikimi i dhunës ekonomike	25
4.2 Baza Ligjore	26
4.2.1 Kodi Penal i Republikës së Kosovës	26
4.2.2 Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje	29
4.3. Propozimet për Ndryshimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje	30
4.3.1 Propozimet e organizatës jo-qeveritare INJECT	30
4.3.2 Procesi i ndryshimit të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje	30
4.4 Obligimet që rrjedhin nga Konventa e Stambollit	31
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	33
Konkluzione	33
Rekomandime	33
6. SHTOJCA 1.	35
Pyetësor për identifikimin e dhunës ekonomike	35
7. BIBLIOGRAFIA	36

Legjislacioni i huaj	36
Legjislacioni vendor	36
Praktika Gjyqësore	36
Të tjera	37

HYRJE

Dhuna ekonomike është një ndër format më të përhapura të dhunës në botë. Megjithatë, literaturës bashkëkohore i mungon një studim i mirëfilltë i këtij fenomeni që sikurse çdo formë tjetër e dhunës në familje dhe ndaj grave, nuk njih kufij socialë, ekonomikë apo kombëtarë.¹ Njëjtë sikurse dhuna fizike, psikologjike e seksuale, edhe kjo formë e dhunës, për fat të keq, prek në mënyrë disproporcionale gratë. Për këtë arsye, fokus kryesor i këtij hulumtimi do të jetë pikërisht analiza e formave të manifestimit dhe pasojave të dhunës ekonomike te gratë e sidomos te të drejtat e tyre pronësore.

Hulumtimi fillon me një elaborim të së drejtës në pronë dhe aspekteve qendrore të saj. Në kapitullin e dytë analizohet dhuna ekonomike në aspektin teorik, përfshirë format e manifestimit të saj, shkaktarët, ndërlidhjen me format e tjera të dhunës dhe pasojat e saj afatgjata. Tutje, praktika e shteteve të jashtme në adresimin e dhunës ekonomike në legjislacion dhe praktikë gjyqësore do të jetë në fokus të kapitullit të tretë, ndërsa në kapitullin e katërt dhe të fundit analizohet korniza ligjore aktuale në Kosovë dhe mundësitë e inkorporimit të dispozitave relevante të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe Ligjit Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, për të adresuar dhunën ekonomike. Hulumtimi përfundon me rekomandimin që në Projektligjin Nr. 07/L-044 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave të përfshihet një definim më gjithëpërfshirës dhe më i satkë i dhunës ekonomike, për t'i hapur rrugë trajtimit më efektiv këtij fenomeni të dëmshëm për gruan dhe shoqërinë.

¹ The Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence against Women and Domestic Violence (Istanbul Convention): Questions and Answers, fq. 2.

1. E drejta në pronë

E drejta në pronë është e drejtë fundamentale e njeriut, respektimi dhe garantimi i së cilës lidhet ngushtë me integritetin personal të një individi.² Ajo konsiderohet bazë e përfshirjes së individit në demokraci, e jo rrallë herë edhe bazë për realizimin e të drejtave të tjera.³ Prandaj, me të drejtë deklarohet se “të drejtat e njeriut pa të drejtën në pronë janë thjeshtë një formulim i mangët.”⁴

Ky kapitull do të trajtojë lindjen dhe evoluimin e të drejtës në pronë, përfshirjen e saj në instrumentet kyçe të së drejtës rajonale dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, objektin e kësaj të drejte si dhe ndërlidhmërinë e saj me të drejtat e tjera civile dhe politike si dhe ato ekonomike, sociale e kulturore. Kapitulli përmbillet me një përmbledhje të të drejtave pronësore në kontekstin e Republikës së Kosovës, me fokus të veçantë në të drejtat pronësore të grave si kategori më pjesëmarrje pakrahasimisht më të ulët se burrat në pronësi.

1.1 Lindja e të drejtës në pronë: nga prona publike te prona private

E drejta në pronë private njihet si pjesë integrale e lirisë dhe prosperitetit të një personi. Gjurmët e saj i gjejmë qysh te Karta e Madhe e Lirive (*Magna Carta*) e nxjerrë në vitin 1215. Përkundër faktit se tani na ndajnë plot tetë shekuj nga nxjerrja e kësaj karte e koncepti i së drejtës në pronë ka pësuar mjaft transformime, njohja e saj përmes Kartës së Madhe të Lirive ka vendosur një bazë të mirëfilltë të mbrojtjes së të drejtës në pronë. Karta ka përcaktuar qartë ndalimin e ndërhyrjes së Mbretit të Anglisë në gëzimin e të drejtës së pronës, përveç kur ajo lejohej me “ligj vendor”. Pra, me të drejtë Karta është interpretuar si një lloj garancie nga privimi arbitrar nga jeta, liria dhe prona.⁵ Përkundër limiteve të saj, përfshirja e të drejtës në pronë në Kartë përbën kthesë revolucionare në njohjen e pronësisë dhe i ka hapur rrugën konstruktimit të versionit modern të pronës si e drejtë.⁶

1.2 Koncepti modern i të drejtës në pronë

Seksionet në vijim shtjellojnë garantimin e të drejtës në pronë në një sërë instrumentesh ndërkombëtare dhe rajonale. Emërues i përbashkët i instrumenteve që do të prezantohen më poshtë është garantimi i të drejtës në gëzim paqësor të pronës dhe njohja e mundësisë së kufizimit të kësaj të drejte nga shteti kur ky kufizim ka bazë ligjore dhe ndjek një qëllim legjitim.

1.2.1 Instrumentet Ndërkombëtare

Një mori instrumentesh ndërkombëtare dhe rajonale e njohin të drejtën në pronë si të drejtë thelbësore të njeriut. Fillimisht, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut garanton të drejtën në pronë me Nenin 17 të saj. Tutje, Konventa mbi Statusin e Refugjatëve përmban disa dispozita nga të cilat derivon njohja e të drejtës së refugjatëve në gëzimin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme. Krahas kësaj, edhe Konventa për Mbrojtjen nga të gjitha Format e Diskriminimit Racor përmban një zotim të përgjithshëm për eliminimin e diskriminimit racor si dhe garantimin e të drejtës për të zotëruar pronën individualisht apo së bashku me të tjerët, por pa u lëshuar shumë në kufizimet e të drejtës në pronë. Ngjashëm me këtë, edhe Konventa kundër Eliminimit të Diskriminimit ndaj Grave i referohet të drejtës së gruas në pronë, në nenin 10 të saj.

Në të vërtetë, komuniteti ndërkombëtar ka humbur mundësinë e artë për të përfshirë të drejtën në pronë në dy instrumentet thelbësore ndërkombëtare, që janë Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike si dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, por kanë qenë vetë rrethanat që kanë shoqëruar nxjerrjen e këtyre dy instrumenteve, që në fakt kanë imponuar lënien menjëherë të së drejtës në pronë. Gjithsesi, një gjë e tillë nuk minon rëndësinë e kësaj të drejte, meqë e njejta është përfshirë në mënyrë shprehimore në një mori instrumentesh ndërkombëtare të përmendura më lartë si dhe në një sërë instrumentesh rajonale që do të shqyrtohen në vijim.

2 Francis Cheneval, “Empowering the poor through property rights,” *University of Zurich*, (2008), fq. 64.

3 Jelena Ristik, “Right to property: From Magna Carta to the European Convention on Human Rights,” p. 145, *Seeu Review*, (2015), fq. 148.

4 Harvery M. Jacobs, “Private Property and Human Rights: A mismatch in the 21st century?” *International Journal of Social Welfare*, (2013), fq. 96.

5 Jelena Ristik, Right to property: From Magna Carta to the European Convention on Human Rights, p. 145, *Seeu Review*, (2015), fq. 153.

6 Po aty, fq. 145.

1.2.2 Instrumentet rajonale

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore i dedikon të drejtës në pronë Nenin 1 të Protokollit 1 të saj, duke përcaktuar se:

“1. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gëzimin paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga zotërimet e tij përveç në interesin publik dhe në varësi të kushteve të parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

2. Dispozitat e mësipërme nuk çenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurisë në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave, të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

Siç mund të vërehet nga formulimi i kësaj dispozite, e njëjta krahas të drejtave në paragrafin 1, njeh edhe kufizime në paragrafin 2. Vetë konteksti i nxjerrjes së Konventës, përkatësisht nxjerrja e saj gjatë udhëheqjes arbitrare dhe abuzimit të pushtetit kanë parashtruar nevojën e vendosjes së masave mbrojtëse ndaj veprimeve të shtetit, në këtë rast, gjatë kufizimit të së drejtës në pronë.⁷

Në nivelin evropian, edhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian garanton të drejtën në pronë në nenin 17. I njëjti i dedikon paragraf të veçantë edhe pronësisë intelektuale.⁸

Më tutje, Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut, në fuqi nga viti 1978, njeh të drejtën e secilit individ në gëzimin dhe përdorimin e pronës. Ngjashëm me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, edhe Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut njeh mundësinë e kufizimit të kësaj të drejte në interesin shoqëror, por gjithmonë duke i vendosur limite ndërhyrjeve të shtetit në gëzimin paqësor të pronës.⁹

Së fundmi, Karta Afrikane e të Drejtave të Njeriut dhe

Popujve, gjithashtu njeh të drejtën në pronë dhe njëkohësisht përcakton interesin e përgjithshëm si bazë të justifikueshme për ndërhyrjen e shtetit në gëzimin paqësor të kësaj të drejte.¹⁰ Marrë parasysh konekstin Afrikan, Karta shkon edhe më larg, duke njohur pronën edhe si të drejtë të popujve si dhe duke garantuar në këtë mënyrë, qasje të barabartë të çdo individ në pronë dhe shërbime publike.¹¹

1.3 Objekti i të drejtës në pronë

Të gjitha instrumentet e përmendura më lartë garantojnë të drejtën në pronë duke njohur gjithashtu mundësinë e kufizimit të saj. Gjithsesi, asnjë nga instrumentet në fjalë, nuk mund të shërbejë si bazë e mjaftueshme për nxjerrjen e një përkufizimi të qartë në lidhje me atë se çfarë (nuk) përbën pronë. Megjithatë, një interpretim më të gjerë të objektit të kësaj të drejte e gjejmë ndër të tjerash në jurisprudencën e mirënjohur të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (këtu e tutje: “GJEDNJ”). Marrë parasysh edhe obligimin që derivon nga Neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës për të interpretuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në harmoni me vendimet e GJEDNJ, në vijim do të paraqiten interpretimet që kjo gjykatë ia ka bërë të drejtës në pronë në disa nga rastet e saj.

Paraprakisht, vlen të theksohet se kontestet pronësore para GJEDNJ janë mjaft të shpeshta, me ç’rast vërehet edhe një problem kronik i respektimit të gëzimit paqësor të pronës nga vendet e Ballkanit Perendimor, anëtare të Këshillit të Europës. Gjithashtu, vlen të theksohet se termin pronë gjykata e barazvlerëson me atë “posedim” dhe këtë të fundit e përdor përgjatë praktikës së saj si zëvendësim për pronën.

Fillimisht, në rastin *Pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës*, Gjykata ka gjetur se posedimi brenda kuptimit të Neni 1 të Protokollit 1 parimisht përfshin posedimet ekzistuese. Më pas, Gjykata ka zgjeruar konceptin e posedimit, duke përcaktuar se në posedime hyjnë edhe asetet, përfshirë këtu edhe paditë për të cilat pala është në gjendje të argumentojë

⁷ Këshilli i Bashkimit Evropian, Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, 14 Dhjetor 2007, Neni 17.

⁸ Christophe Golay and Ioana Cismas, Legal Opinion: The Right to Property from a Human Rights Perspective, *International Centre for Human Rights and Democratic Development & Geneva Academy of International Humanitarian Law and Human Rights*, (2010), fq. 5.

⁹ Organizata e Shteteve Amerikane, *Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut*, 22 Nëntor 1969, Neni 21.

¹⁰ Organizata e Unitetit Afrikan, *Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve*, 27 Qershor 1981, Neni 14.

¹¹ Po aty, Neni 13(3).

se ka pritshmëri legjitime për të siguruar një të drejtë pronësore në mënyrë efektive.¹²

Në disa nga rastet vijuese, Gjykata ka sqaruar se vetëm të shpresuarit për të ju njohur e drejta në një pronë, të cilin kërkuesi/ja nuk ka mundur ta gëzojë më herët në mënyrë efektive, nuk mund të konsiderohet pritshmëri legjitime, rrjedhimisht as posedim për qëllim të Nenit 1 të Protokollit 1. Ngjashëm me këtë, as padia e kushtëzuar, që nuk mund të fitohet si rezultat i mospërbushjes së kushtit të caktuar, nuk bie në fushën e të njëjtës dispozitë.¹³ Konceptin e mbrojtjes së pritshmërisë apo interesit legjitim në kuadër të Nenit 1 të Protokollit 1, Gjykata e ka elaboruar edhe më thellë në rastet *Kopecky kundër Sllovakisë, Saghindaze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë, Ceni v. Italy etj*, me ç'rast ka ardhur në përfundimin se për tu konsideruar legjitime, një pritshmëri duhet të ketë natyrë shumë konkrete si dhe të jetë e bazuar në ligj apo vendim gjyqësor. Më konkretisht, në rastin *Fedulov kundër Rusisë*, GJEDNJ ka arritur në përfundimin se kualifikimi/e drejta e një personi me aftësi të kufizuara për qasje pa pagesë në barëra për trajtimin e kancerit, përbën pritshmëri legjitime dhe si e tillë ankesa mund të trajtohet në kuadër të Nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës.¹⁴

Bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ, posedim në kuptimin e Nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës përbëjnë edhe paditë dhe aktvendimet. Lidhur me këtë, Gjykata ka përcaktuar që me qëllim të shqyrtimit të një padie në kuadër të Nenit 1 të Protokollit 1, kërkuesi duhet të dëshmojë se e njëjta ka bazë të mjaftueshme ligjore, të vërtetuar edhe nga praktika gjyqësore nacionale.¹⁵

Në vazhdim, Gjykata ka pasur rastin të trajtojë në kuadër të Nenit 1 të Protokollit 1 edhe aksionet dhe instrumentet tjera financiare. Kështu, aksionet me vlerë, të cilat ia mundësojnë aksionarit të ushtrojë ndikim në kompaninë e caktuar, mund të konsiderohen posedim.¹⁶

Më tutje, GJEDNJ ka trajtuar në frymën e Nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës edhe pensionet e përfitimet e tjera sociale. Duke pasur konsideratë të lartë ndaj faktit që jeta e shumë njerëzve varet në masë të madhe nga këto përfitime, GJEDNJ ka përcaktuar se një e drejtë e fituar ndaj një përfitimi social në të drejtën vendore, implikon aplikueshmërinë e Nenit 1 të Protokollit 1.¹⁷

Së fundmi, posedim sipas Gjykatës konsiderohet edhe pronësia intelektuale, e regjistruar apo ajo për të cilën është inicuar aplikim për regjistrim.¹⁸

1.4 E drejta në pronë dhe ndërlidhmëria me të drejtat e tjera themelore

1.4.1 E drejta në pronë dhe të drejtat civile dhe politike

E drejta në pronë, krahas të qenit e drejtë e njerut, nga shumë autorë është konsideruar edhe si e drejtë strategjike për faktin që gëzon lidhmëri të ngushtë me të drejtat e tjera si dhe mund të shërbejë si bazë për realizimin e tyre. Kështu, GJEDNJ ka gjetur lidhmëri të ngushtë mes të drejtës në pronë dhe të drejtës në jetë,¹⁹ të drejtës për të qenë i lirë nga trajtimi mizor, çnjerëzor dhe degradues,²⁰ të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm,²¹ të drejtës në jetë private dhe familjare,²² e kështu me radhë. Por krahas kësaj ndërlidhmërie, si e drejtë strategjike e drejta në pronë lidhet ngushtë edhe me të drejtat socio-ekonomike që do të trajtohen në seksionin e radhës.

12 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës*, 20 Nëntor 1995, paragraf. 31.

13 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Nerva dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 15 Maj 1996, paragraf. 43; *Stretch kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 24 Qershor 2003, paragraf. 30.

14 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Fedulov kundër Rusisë*, 8 Tetor 2019, paragrafët. 70-72.

15 Po aty, paragraf. 2.

16 Po aty, paragraf. 31.

17 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Stec dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 6 Korrik 2005, paragraf. 51; *Moskal kundër Polonisë*, 15 Shtator 2009, paragraf. 39; *Andrejeva kundër Letonisë*, 18 Shkurt 2009, paragraf. 77.

18 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Anheuser-Busch Inc kundër Portugalisë*, 11 Janar 2007, paragraf.

19 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Oneriyildiz kundër Turqisë*, 30 Nëntor 2004, paragrafët. 136-137,

20 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Pancenko kundër Letonisë*, 28 Tetor 1999, paragraf.

21 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Raimondo kundër Italisë*, 22 Shkurt 1994, paragraf. 43.

22 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Vaskrsic kundër Rusisë*, paragraf. 87.

1.4.2 E Drejta në pronë dhe të drejtat socio-ekonomike

E drejta në pronë i kontribuon në mënyrë të konsiderueshme realizimit të të drejtave socio-ekonomike, me theks të veçantë të drejtës në banim adekuat, ushqim dhe siguri sociale.²³ Kjo demonstron më së miri përmes jurisprudencës së pasur të Komisionit Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve, respektivisht gjetjeve të saj në rastet *Ogoni dhe Enderois*.²⁴ Në saje të kësaj lidhërie, mungesa e pronës përbën një ndër shkaktarët më të shpeshtë të varfërisë dhe atë jo vetëm në vendet e varfëra. Prandaj, ndërlidhja kauzale në mes të mungesës së të drejtave pronësore dhe varfërisë është duke zënë gjithnjë e më tepër vend në literaturë²⁵ dhe në këtë kontekst edhe dhuna ekonomike ndaj grave duhet të shihet përmes këtij prizmi.

Megjithatë, duhet pasur parasysh se garantimi i të drejtave pronësore në legjislacion jo gjithmonë përkthehet në të drejta pronësore edhe në praktikë. Përkundër përpjekjeve për barazi dhe solidaritet, diskriminimi dhe klasifikimi shoqëror mbeten të gravuara thellë në shumë vende. Prandaj, sigurimi i të drejtave pronësore me legjislacion, por pa i siguruar edhe mekanizmat që bëjnë të mundur avancimin e mentalitetit dhe ndryshimin e praktikave diskriminuese në të gjitha nivelet e shoqërisë, është i pamjaftueshëm.²⁶

1.5 Obligimet e shtetit kundrejt të drejtës në pronë

E drejta në pronë sikurse edhe të drejtat e tjera të njeriut, implikon obligimin e shtetit që të njëjtën ta respektoj, mbroj dhe përmbushë, pra implikon obligime pozitive dhe negative në kurriz të shtetit.

Fillimisht, respektimi i të drejtës në pronë nënkupton obligimin e shtetit që të përmbahet nga ndërhyrja

arbitrare në gëzimin paqësor të kësaj të drejte. Për qëllime ilustrimi, ekspropriimi i pronës, pa bazë të mirëfilltë ligjore apo në mungesë të interesit publik, përbën shkelje të obligimit të respektimit të së drejtës në pronë.²⁷

Përveç se të respektohet, e drejta në pronë duhet edhe të mbrohet, përmes ndërmarrjes së të gjitha masave të nevojshme ligjore, administrative e gjyqësore, për të penguar cënimin nga palët e treta. Në këtë rast, dështimi i shtetit të mbrojë pronën nga shkatërrimi dhe dëbimi nga palët e treta, mund të rezultojë në shkeljen e obligimit për të mbrojtur këtë të drejtë.²⁸

Së fundmi, para shteteve shpeshherë paraqitet obligimi për të ndërmarrë masa pozitive drejt përmbushjes së të drejtës në pronë. Në veçanti, shteti obligohet të ndërmarrë hapa pozitivë në rastet kur ekziston një lidhje direkte në mes të pritshmërive legjitime të individit për këto masa dhe mundësisë së saj/tij ta gëzojë pronën.²⁹ Për ilustrim, rasti *Oneryildiz* është një ndër rastet ku Gjykata dënoi dështimin e Turqisë për mosndërmarrjen e të gjitha hapave që kishte në dorë për të mbrojtur interesin pronësor të kërkuesit nga rreziku i shkatërrimit që autoritetet vendore e kanë ditur apo është dashur ta dijnë.³⁰ Kësisoj, autoritetet turke u shpallën fajtores për shkelje të së drejtës në pronë.³¹

1.6 Të Drejtat Pronësore në kontekstin kosovar

Përkundër faktit që gratë përbëjnë gati gjysmën e popullsisë botërore, vlerësohet se përafërsisht vetëm 10% e tyre gëzojnë të drejtën në pronë.³² Në skenarin më të mirë, kjo përqindje *de jure* rritet, por *de facto*, prona në shumë raste menaxhohet nga burrat.³³ Një skenar i tillë më së miri përshkruan edhe situatën në Kosovë, ku megjithëse e drejta në pronë garantohet me Kushtetutë, me Ligjin për Familjen, Ligjin për

23 Harvery M. Jacobs, "Private Property and Human Rights: A mismatch in the 21st century?" *International Journal of Social Welfare*, (2013), fq. 97.

24 Komisioni Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve, *Ogoniland Case*, 155/96 2002; *Centre for Minority Rights Development (Kenya) and Minority Rights Group International on behalf of Endorois Welfare Council v. Kenya*, 276/2003.

25 Francis Cheneval, "Empowering the poor through property rights," *University of Zurich*, (2008), fq. 64.

26 Po aty, fq. 69.

27 Christophe Golay and Ioana Cismas, "Legal Opinion: The Right to Property from a Human Rights Perspective," *International Centre for Human Rights and Democratic Development*, (2010), fq. 28.

28 Po aty.

29 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Oneryildiz kundër Turqisë*, 30 Nëntor 2004, paragraf. 134.

30 Po aty, paragrafët. 134, 135, 138.

31 Po aty, paragraf. 138.

32

33 Francis Cheneval, "Empowering the poor through property rights," *University of Zurich*, (2008), fq. 65.

Trashëgimi dhe Strategjinë Kombëtare për të Drejtat Pronësore, gratë ende mbesin të përfaqësuara në pronë në një përqindje të ulët. Kjo më së shumti për shkak të stereotipeve të rrënjosura lidhur me pozitën e gruas në familje dhe shoqëri.

Viti 2021 e gjen Kosovën me vetëm 17% të grave që gëzojnë pronë,³⁴ dhe me vetëm 12.3% gra të punësuara.³⁵ Këto statistika dëshmojnë më së miri për gjendjen e rëndë të të drejtave pronësore të grave në Kosovë. Këtë gjendje e rëndon edhe më tepër dhuna ekonomike e cila prekë direkt të drejtat pronësore edhe ashtu të kufizuara, të grave në Kosovë. Një përmbledhje teorike dhe praktike e dhunës ekonomike dhe ndikimit të saj në të drejtat pronësore të grave do të ofrohet në kapitujt në vijim.

2. Dhuna ekonomike

Ky kapitull hedh dritë mbi konceptin e dhunës ekonomike përmes elaborimit të formave të manifestimit të saj, shkaktarëve që shtyjnë drejt kësaj dhune, ndërlikohet me format e tjera të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave si dhe pasojave të mëdha e afatgjata që dhuna ekonomike lë në jetën e viktimave që ballafaqohen me të.

2.1 Definimi i dhunës ekonomike

Dhuna konsiderohet shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut, një shqetësim i madh global që në mënyrë disproporcionale prekë gratë. Përafërsisht një në tri gra preket nga dhuna përgjatë jetës së saj dhe në shumicën e vendeve të botës shtëpia mbetet vendi më i pasigurt për të jetuar për gratë.³⁶ Prandaj eliminimi i dhunës ndaj grave njihet si një ndër prioritetet kryesore të komunitetit ndërkombëtar.³⁷ Dhuna ndaj grave më së shpeshti manifestohet si dhunë fizike, seksuale dhe psikologjike. Lidhur me këto forma, tanimë ekziston një literaturë mjaft e bollshme, mirëpo literaturës moderne i mungon një studim i mirëfilltë i një forme tjetër të dhunës e cila deri vonë është trajtuar në kuadër të dhunës psikologjike. Bëhet fjalë për dhunën ekonomike, forma e dhunës me nivele tejet të larta të prezencës në çdo shoqëri. Përkundër kësaj, shumica e instrumenteve vendore dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut kanë dështuar në njohjen dhe përfshirjen e dhunës ekonomike si formë të vecantë, duke i lënë hapësirë trajtimit të saj vetëm në kuadër të dhunës psikologjike. Në lidhje me këtë, studimet e fundit rekomandojnë se dhuna ekonomike është unike në shumë aspekte, prandaj edhe duhet të trajtohet si e tillë.³⁸ Një hap revolucionar në këtë drejtim, është ndërmarrë së fundmi me Konventën e Stambollit e cila ka hyrë në fuqi më 1 Gusht të vitit 2014 dhe deri në ditët e sotme gëzon 34 ratifikime.³⁹ Në nenin 3 e njëjta njeh dhe ndëshkon dhunën ekonomike, por pa u lëshuar në të përcaktuarit se çfarë përbën në fakt dhunë ekonomike, si manifestohet dhe si duhet të adresohet

34 Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), Pilot Indeksi për të Drejtat Pronësore të Grave, *QKSGJ*, (2020) fq. 8.

35 Po aty.

36 Jeni Klugman, "Gender based violence and the law," *Georgetown University*, (2017), fq. 4.

37 Po aty, fq. 1.

38 Amanda M. Stylianou, "Economic Abuse within Intimate Partner Violence: A Review of the Literature," *New York*, (2018), fq. 8.

39 Council of Europe, signatures, Shih: <https://www.coe.int/en/wwb/conventions/full-list/-/conventions/treaty/210/signatures> qasja e fundit (24-5-2021).

ajo. Një definim të dhunës ekonomike nuk e gjejmë as në Raportin Shpjegues të kësaj Konvente.⁴⁰

Kësisoj, në mungesë të një instrumenti ndërkombëtar që sqaron dhunën ekonomike, një definim më të plotë të saj e gjejmë në burimet sekondare të së drejtës, respektivisht në literaturën juridike, ku termi dhunë ekonomike kryesisht i referohet “kontrollit jo të barabartë të resurseve të përbashkëta, mohimit të qasjes në para, punë dhe arsimim,”⁴¹ “kontrollit dhe monitorimit të vazhdueshëm të shpenzimeve të një personi si dhe kërcënimit të vazhdueshëm të mohimit të qasjes në mjete financiare.”⁴²

Nga këto definicione derivon se kjo formë e dhunës cënon sigurinë ekonomike dhe vetëmjaftueshmërinë e një personi,⁴³ e meqë studimet demonstrojnë se dhuna ekonomike në mënyrë tipike prekë gratë, ky hulumtim do të zhvillohet rreth ndikimit të dhunës ekonomike pikërisht te kjo kategori.

2.2 Në çfarë formash manifestohet dhuna ekonomike?

Dhuna ekonomike mund të manifestohet në shumë forma, nga privimi i partneres në qasje në para deri te shpenzimi i parave të partneres pa dëshirën e saj. E njëjta mund të manifestohet edhe si hyrje në borxh në emër të partneres, si dhe dëmtim i posedimeve/pasurisë së saj. Një tjetër formë e dhunës ekonomike është edhe refuzimi i përmbushjes së obligimit të ushqimisë.⁴⁴ Të gjitha këto dhe shumë forma të tjera të cilat do të prezantohen në vijim, autorët i kanë grupuar në tri kategori: “eksploatim ekonomik”, “kontroll ekonomik” dhe “sabotim i punësimit.”⁴⁵ Në lidhje me këtë, kontrolli ekonomik konsiston në kufizimin e mundësisë së

partneres për të përdorur në mënyrë të lirshme resurset e saj. Në anën tjetër, eksploatimi ekonomik i referohet shterrimit të pasurisë ekzistuese apo hyrjes në borxh në emër të partneres dhe krijimit të mëtejme të obligimeve financiare. Së fundmi, kur flitet për sabotim të punësimit, autorët nënkuptojnë pengimin e partneres në aftësim profesional dhe punësim.⁴⁶

2.2.1 Kufizimi i qasjes në para

Qasja e barabartë në para e grave dhe burrave përbën parakusht për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave. Gjithashtu, një qasje e barabartë është me rëndësi jetike për të arritur një zhvillim ekonomik të drejtë dhe të qëndrueshëm,⁴⁷ që çon në zbutjen e varfërisë dhe rritjen e mirëqenies së grave dhe fëmijëve.⁴⁸ Megjithatë, kjo për shumë gra anë e mbanë globit, mbetet privilegj dhe jo një e drejtë.

Kështu, dhuna ekonomike më së shumti vjen në shprehje si privim i qasjes së partneres në mjetet financiare të përbashkëta apo individuale. Kryerësi i dhunës ekonomike, jo rrallëherë, privon viktimën nga paratë e nevojshme për të mbuluar nevojat esenciale si ushqim dhe veshëmbathje, për vete dhe për fëmijët, apo edhe kur iu jepet para, ato kufizohen në mënyrë strikte vetëm në mbulimin e nevojave që partneri në vlerësimin subjektiv të tij i sheh si esenciale, por asgjë më tepër se aq.⁴⁹ Madje, në disa raste, partnereve i është ndaluar blerja e gjërave që sipas abuzuesit nuk hyjnë në “gjërat e domosdoshme” Për ilustrim, një rës prej viktimave i është ndaluar blerja e produkteve higjienike si sapun duarsh apo letra toaleti meqë, sipas partnerit, nuk hynin në kategorinë e produkteve esenciale.⁵⁰ Në një rast tjetër, abuzuesi e privonte partneren e tij nga mundësia për të blerë rroba të ngrohta gjatë dimrit,

40 Council of Europe, Explanatory Report to the Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence, (2011).

41 Tatjana Duric Kuzmanovic, Ana Pajvancic-Cizelj, “Economic violence against women: Testimonies from the Women’s Court in Sarajevo,” *European Journal of Women Studies*, (2020), fq. 26.

42 Po aty.

43 Omer Alkan, Senay Ozar and Seyda Unver, Economic violence against women: A case in Turkey, *PLoS ONE*, (2021), fq. 2.

44 The Co-operative Bank, “My Money, My Life: A financial guide for victims of domestic violence,” *Refuge*, (2008), fq. 9.

45 Judy Postmus, Kristina Nikolova, Hsiu-Fen Lin and Laura Johnson, “Women’s Economic Abuse Experiences: Results from the UN Multi-Country Study on Men and Women in Asia and the Pacific,” *Journal of Interpersonal Violence*, (2021), p. 3.

46 Amanda Mathisen, Judy Postmus, Sarah McMahon, “Measuring Abusive Behaviours: Is Economic Abuse a Unique form of abuse?” *Journal of Interpersonal Violence*, (2013), p. 189.

47 United Nations, Department of Economic and Social Affairs, Division for the Advancement of Women, 2009 Survey on the Role of Women in Development, Women’s Control over Economic Resources and Access to Financial Resources, including Microfinance, UN, (2009), fq. 1.

48 Po aty.

49 Adriene Adams, “Cris Sullivan, Deborah Bybee and Megan Greeson, Development of the Scale of Economic Abuse,” *Sage Publications*, (2008), fq. 566.

50 Ellie Butt, “Know Economic Abuse, 2020 Report,” *Refuge*, (2020), fq. 34.

për të blerë ushqim gjatë pauzave të punës apo edhe nga mundësia për të paguar transportin për në punë, gjë që ia impononte asaj vajtje-ardhjen në këmbë, e që i merrte hiç më pak se 2 orë në ditë.⁵¹ Nga literatura në këtë fushë, derivon se dhunë ekonomike, po ashtu përbën, vënia e partnerit në atë pozitë që çdoherë të ketë nevojë të kërkojë një shumë të caktuar të parave për çdo gjë që i nevojitet.⁵²

Privimi i qasjes në mjete financiare konsiston edhe në kufizimin dhe ndalimin e përdorimit të lirshëm të llogarisë bankare të përbashkët apo individuale. Në një studim të kryer nga autorët Bettio dhe Ticci, 19% e të intervistuarave në studim u përgjigjën se qasja e tyre në llogari bankare ishte kufizuar në mënyrë të pjesërishme apo të tërësishme. Në anën tjetër, 10% të pjesëmarrëseve në studim pohuan të kenë pasur një llogari të përbashkët bankare, por pa mundësi qasjeje në të. 11% nuk u lejuan fare të hapin llogari bankare personale. Nga 11% të atyre që kishin llogari personale bankare, kjo e fundit ishte nën kontrollin absolut të partnerit.⁵³ Pra, përveç mosdhënies së parave për nevoja esenciale dhe ndalimit të shfrytëzimit të parave të përbashkëta, jo rrallëherë dhuna ekonomike merr formën e ndalimit të përdorimit të parave të cilat vetë partnerja i ka fituar.⁵⁴

Gjithsesi, praktika ka dëshmuar se dhuna ekonomike nuk kufizohet vetëm në kontrollimin e qasjes në para por edhe në ushqim, veshmbathje, transport dhe banim, dhe meqenëse e njëjta nuk kërkon praninë fizike, ajo mund të fillojë në çdo kohë, si para ashtu edhe pas martesë.⁵⁵

2.2.2 Monitorimi i detajuar i shpenzimeve të partneres

Monitorimi i detajuar i shpenzimeve të partneres

përmes llogarive bankare online, përbën një formë tjetër të kontrollit financiar. Kështu, disa pjesëmarrëse në një studim janë përgjigjur se bankimi online u ka hapur rrugë partnerëve të tyre për të monitoruar shpenzimet e tyre, deri në detaje. Madje, deri në atë pikë ku disa partnerë kanë aktivizuar butonin e “njoftimeve” për të ditur se kur dhe ku po shpenzon para partnerja. Një gjë e tillë e ka zvogëluar dukshëm pavarësinë financiare të viktimitave.⁵⁶

Më tutje, kërkimi dhe kontrollimi i kuponave fiskalë përbën një formë tjetër përmes të cilës abuzuesit ushtrojnë dhunë ekonomike.⁵⁷ Ky lloj monitorimi i hapë rrugën një kontrolli të plotë financiar ndaj grave, që shpeshherë eskalon edhe në dhunë fizike kur këto të fundit mundohen të kamuflojnë ndonjë shpenzim, ndërsa kuponat fiskalë vërtetojnë të kundërtën.⁵⁸

2.2.3 Marrja e njëanshme e vendimeve të rëndësishme financiare

Jo rrallëherë dhunë ekonomike përbën edhe marrja e vendimeve lidhur me shpenzimet shtëpiake në mënyrë të njëanshme, pra pa u konsultuar fare me partneren në lidhje me atë se ku po shpenzohen apo kursehen paratë.⁵⁹ Privimi nga vendimmarrja e përbashkët financiare njihet si dhunë ekonomike edhe me legjislacion. Kështu, Australia është ndër vendet e para që përcakton se dhuna ekonomike ndër të tjerash konsiston në “privimin e paarsyeshëm të një individi nga pjesëmarrja në vendimet lidhur me shpenzimet familjare apo disponimin e pasurisë.”⁶⁰

2.2.4 Refuzimi për të kontribuar në shpenzimet familjare

Dhuna ekonomike mund të manifestohet edhe me refuzimin e kontribuimit në shpenzimet familjare.

51 Sundari Anitha, “Understanding Economic Abuse Through an Intersectional Lens: Financial Abuse, Control and Exploitation of Women’s Productive and Reproductive Labor,” (2019), fq. 1868.

52 Adriene Adams, Cris Sullivan, Deborah Bybee and Megan Greeson, “Development of the Scale of Economic Abuse,” *SAGE Publications*, (2008), fq. 566.

53 Francesca Bettio and Elisa Ticci, “Violence Against Women and Economic Independence,” (2017), fq. 18.

54 Adriene Adams, Cris Sullivan, Deborah Bybee and Megan Greeson, “Development of the Scale of Economic Abuse,” *SAGE Publications*, (2008), fq. 566.

55 Economic Abuse Survivors, paragraf. 7.

56 Ellie Butt, “Know Economic Abuse, 2020 Report,” *Refuge*, (2020), fq. 32.

57 Cynthia Sanders, “Economic Abuse in the Lives of Women Abused by an Intimate Partner: A Qualitative Study,” *Violence Against Women*, (2014), fq. 13.

58 Ellie Butt, “Know Economic Abuse, 2020 Report,” *Refuge*, (2020), fq. 33.

59 Olufunmilyao Fawole, “Economic Violence to Women and Girls: Is it receiving the necessary attention?” *University College Hospital, Ibadan, Nigeria*, fq. 168.

60 https://goodshep.org.au/wp-content/uploads/2020/12/economic-abuse_final-report.pdf, p. 1.

Studimet tregojnë për shumë partnerë të cilët refuzojnë të ndajnë shpenzimet e faturave familjare, si ato të qirasë, ujit dhe energjisë elektrike, duke lënë çdo faturë në emër të viktimave, gjë e cila e rëndon shumë gjendjen e tyre financiare.⁶¹

2.2.5 Eksploatimi i resurseve

Eksploatimi i resurseve financiare është një ndër format tipike të dhunës ekonomike, që mund të realizohet nga bashkëshorti, por përveç tij edhe nga familjarët e tij. Seksionet në vijim elaborojnë më në detaje këtë çështje. Rastet e diskutuara janë marrë nga studimet apo vendimet gjyqësore të vendeve përkatëse, të cilat e kanë rregulluar me ligj ndëshkimin e dhunës ekonomike.

2.2.5.1 Nga partneri

Përveç në mosdhënien e parave nga të hyrat e tij, dhuna ekonomike shpeshherë manifestohet edhe në përvetësimin e të hyrave financiare të partneres si formë efektive e kontrollit ndaj saj. Marrja e parave nga partnerja, përveç se dëmton dukshëm buxhetin e saj, të njëjtës ia limiton mundësitë e largimit nga një lidhje abuzive. Rëndom, eksploatimi i resurseve të partneres shfaqet në formë të vjedhjes së parave nga partnerja, hyrjes në borxh në emër të saj si dhe detyrimit të saj për të kërkuar lëmoshë në rrugë apo para nga të afërmit.⁶²

2.2.5.2 Nga anëtarët e familjes së tij

Kur flitet për dhunën në përgjithësi, e në këtë rast dhunën ekonomike në veçanti, shumica e njerëzve krijojnë në mendje imazhin e një burri abuzues kundrejt një gruaje viktimë. Por praktika ka dëshmuar se edhe vetë gratë mund t'i abuzojnë gratë. Këtu bëjmë fjalë për rrethin familjar të burrit, të cilët paralelisht me të, mund të ushtrojnë presion të formave të ndryshme mbi viktimën. Kjo vjen në shprehje veçanërisht në vendet ku mbizotëron tradita e bashkëjetesës me familjen e

gjerë e ku gratë jetojnë bashkë me prindërit dhe/apo vëllezërit e motrat e bashkëshortëve të tyre. Përderisa studimet kanë treguar se në Mbretërinë e Bashkuar 92% e kryerësve të dhunës në familje janë meshkujt, për dallim nga kjo, në zonat jugore të Azisë, gratë përbëjnë rreth 33-40% të kryerësve të dhunës.⁶³ Në njërin nga hulumtimet, një prej të intervistuarave, dëshmon të ketë përjetuar dhunë fizike dhe ekonomike nga burri i saj, e paralelisht me të edhe dhunë psikologjike nga familja e tij, e në veçanti nga nëna e tij.⁶⁴ Një viktimë tjetër e dhunës ekonomike dëshmon se si ajo mbante dy puna, e megjithatë asnjëherë nuk merrte asnjë përfitim financiar, meqë ai përfundonte në duart e bashkëshortit dhe rrethit të tij familjar. Përkundër faktit se i gjithë pazari familjar realizohej me paratë e fituara nga ajo, viktima nuk merrte pjesë asnjëherë në të dhe e tërë ajo çfarë mund të vishte ishin rrobat e përdorura nga të tjerët.⁶⁵

2.2.5.3 Eksploatimi i të moshuarave

Dhuna ekonomike në formë eksploatimi nuk kursen as personat në moshë të shtyer në përgjithësi, e gratë e moshuara në veçanti. Eksploatimi i personave në moshë i referohet marrjes dhe keqpërdorimit të resurseve materiale të të moshuarave nga personat e tjerë.⁶⁶ Dhuna ekonomike ndaj të moshuarve është prezente në masë të madhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku vlerësohet se në baza vjetore afër 5 milion të moshuar abuzohen financiarisht me humbje financiare që kapin shifrën prej 36.5 miliardë dollarësh amerikan.⁶⁷

Në veçanti, kjo formë e dhunës është mjaft karakteristike edhe për vendet me prirje të fortë partiarkale, ku mbizotëron ideja e sakrificës së nënave/gjysheve për fëmijët dhe mbesat/nipërit e tyre, e ku nga të moshuarat pritet që të ofrojnë kujdes ndaj mbesave/nipërve dhe shtëpive të tyre. Ky kujdes jo vetëm që realizohet pa kurrfarë këmbimi monetar, por shpeshherë nga këto gra në moshë pritet që me pensionet e tyre edhe ashtu

61 Cynthia Sanders, "Economic Abuse in the Lives of Women Abused by an Intimate Partner: A Qualitative Study," *Violence Against Women*, (2014), fq. 16.

62 Adriene Adams, Cris Sullivan, Deborah Bybee and Megan Greeson, "Development of the Scale of Economic Abuse," *SAGE Publications*, (2008), fq. 567.

63 Sundari Anitha, "Understanding Economic Abuse Through an Intersectional Lens: Financial Abuse, Control and Exploitation of Women's Productive and Reproductive Labor," *SAGE Publications*, (2019) fq. 1866-1867.

64 Truchero, "Economic violence, a form of domestic violence," (2013), fq. 67.

65 Sundari Anitha, "Understanding Economic Abuse Through an Intersectional Lens: Financial Abuse, Control and Exploitation of Women's Productive and Reproductive Labor," *SAGE Publications*, (2019) fq. 1868.

66 Get the Facts on Elder Abuse, (2021) shih: <https://www.ncoa.org/article/get-the-facts-on-elder-abuse>.

67 Po aty.

modeste t'i kontribuojnë ekonomisë familjare, duke lënë kështu nevojat e tyre për ushqim më cilësor dhe barëra në plan të dytë. Pikërisht ky perceptim i grave të moshuara si sakrifikuese për familje ka ndikuar që marrjen e pensioneve të tyre dhe eksplotimin e punës së tyre të mos e konsiderojnë e, rrjedhimisht as raportojnë si dhunë financiare.⁶⁸

2.2.6 Vjedhja dhe dëmtimi i pasurisë së partneres

Jo më pak se 38% e grave të pranishme në studimin e Andreson dhe të tjerët, raportuan të kenë qenë viktimë e vjedhjes së parave nga vetë partneri i tyre.⁶⁹ Krahas vjedhjes edhe dëmtimi i pasurisë së gruas dhe asaj familjare është një nga format e shpeshta të dhunës ekonomike, dhe manifestohet me vjedhjen dhe dëmtimin e posedimeve si veturës, orendive dhe paisjeve të tjera elektroshtëpiake. Një gjë e tillë dëmton rëndë ekonominë e grave meqë këto të fundit duhet t'i orientojnë resurset materiale drejt blerjes së produkteve të dëmtuara apo riparimit të tyre. Shpesh kjo formë manifestohet edhe me këputjen e sistemit të ngrohjes, atij elektrik apo telefonisë mobile, që më pas implikojnë shpenzime të rregullimit të tyre.⁷⁰

2.2.7 Hyrja në kredi në emër të partneres

Formë tipike e dhunës ekonomike është edhe hyrja në kredi në emër të partneres, që këtë të fundit e thëllon në varësi financiare ndaj partnerit abuziv, duke ia bërë të vështirë shkëputjen nga lidhja dhe rikuperimin financiar në rast të shkëputjes.⁷¹ Vlerësohet se afro 60% e grave zhyten në borxhe si pasojë direkte e dhunës ekonomike,⁷² që me raste mund të manifestohet përmes

detyrimit të partneres për të marrë kredi, detyrimit të saj për të nënshkruar dokumente të ngjashme financiare apo në disa raste edhe përmes lënies së shtëpisë, pasurisë familjare në hipotekë pa dijeninë e partneres.⁷³

2.2.8 Pengimi i punësimit dhe ngritjes në detyrë

Jo rastësisht puna vlerësohet si burimi kryesor dhe shpeshherë i vetmi, i të hyrave financiare të njerëzve, përmes të cilës ata janë në gjendje të plotësojnë nevojat e tyre prej më elementareve. Në ditët e sotme, është më se e zakonshme të dëgjojmë për fuqizimin e grave përmes punësimit e rëndësia e punësimit të grave më së miri reflektohet në Objektivin e tretë të Mijëvjeçarit, i destinuar ekskluzivisht për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.⁷⁴ Megjithatë, si pasojë e rrethanave në të cilat një numër i madh i grave sot jetojnë dhe veprojnë, jo të gjitha kanë qasje në punë. Prapa kësaj, shpeshherë qëndrojnë burrat, të cilët të shtyrë nga mentaliteti patriarkal ndalojnë dhe dekurajojnë partneret e tyre për tu kyçur në tregun e punës.⁷⁵ Me qëllim të pengimit të punësimit të grave të tyre, disa burra përdorin forma si shkaktimi i lëndimeve të dukshme, ndalja e alarmit dhe/apo refuzimi për t'i ofruar përkujdesje fëmijëve gjatë paraqitjes së grave për intervistë pune, e kështu me rradhë.⁷⁶

Në anën tjetër, disa gra shpeshherë janë ballafaquar me të kundërtën. Respektivisht, partnerë që atyre ia kanë imponuar vendin e punës dhe kohëzgjatjen e saj. Lidhur me këtë, disa gra detyrohen të punojnë dhe atë me më shumë se një orar.⁷⁷ Për shembull, njëri nga të atakuarat nga dhuna ekonomike, i ishte imponuar puna

68 Nevena Petrusic, Natasa Todorovic, Milutin Vracevic and Brankica Jankovic, "Financial Abuse of Older Women in Serbia," *Journal of Elder Abuse and Neglect*, (2015), fq. 417.

69 Michael Anderson dhe të tjerët, "Why doesn't she just leave?": A Descriptive Study of Victim Reported Impediments to Her Safety," *Journal of Family Violence*, (2003), fq. 153.

70 Adriene Adams, Cris Sullivan, Deborah Bybee and Megan Greeson, "Development of the Scale of Economic Abuse," *SAGE Publications*, (2008), fq. 567.

71 Anna Lindskog, "The Indivisibility of Economic Violence in the Swedish Legal and Gender Equality Policy Discourse," *Umea University*, (2020), fq. 24-25.

72 Surviving Economic Abuse, "Domestic Abuse Bill: The inclusion of economic abuse and the need for a post-separation economic abuse amendment," *SEA*, (2020), fq. 1. Shih: https://survivingeconomicabuse.org/wp-content/uploads/2021/01/SEA-briefing-DA-Bill-For-HL-Second-Reading_September-2020-FINAL-1.pdf.

73 NCDVA, "Facts about Domestic Violence and Economic Abuse." Shih: https://assets.speakcdn.com/assets/2497/domestic_violence_and_economic_abuse_ncadv.pdf.

74 United Nations, Department of Economic and Social Affairs, Division for the Advancement of Women, "2009 Survey on the Role of Women in Development, Women's Control over Economic Resources and Access to Financial Resources, including Microfinance," *UN*, (2009), fq. 27.

75 Jinan Usta, Nisrine Makarem and Rima Habib, "Economic Abuse in Lebanon: Experiences and Perceptions," *American University of Beirut*, (2013), fq. 357.

76 Adriene Adams, Cris Sullivan, Deborah Bybee and Megan Greeson, "Development of the Scale of Economic Abuse," *SAGE Publications*, (2008), fq. 565.

77 Sundari Anitha, "Understanding Economic Abuse Through an Intersectional Lens: Financial Abuse, Control and Exploitation of Women's Productive and Reproductive Labor," *SAGE Publications*, (2019), fq. 1869.

vetëm në biznesin e ish-bashkëshortit, me një pagesë modeste e cila përsëri derdhej në xhirollogarinë e përbashkët familjare, në të cilën viktimës i ishte mohuar qasja meqë kartelat mbaheshin në kuletën e partnerit.⁷⁸ Ngjashëm me këtë, në një rast tjetër, njëra nga viktimat që ishte pjesë e një prej studimeve, punonte në dyqanin e familjes për 8-10 orë në ditë, pa u kompensuar asnjë herë të vetme për punën që bënte. Kur gruaja mori guximin të merrte tinëzisht shuma modeste nga dyqani, për nevoja shtëpiake, kjo përcillej me dhunë fizike.⁷⁹

Për sa i përket disa të tjerave, që kanë pasur fatin të punojnë, të njëjtat i janë nënshtruar shumë kufizimeve, ndër to më i shpeshti pengimi i socializimit me kolegët e punës. Ky pengim shpeshherë shkon në monitorim konstant të bisedave dhe sjelljeve të partneres, akuza për afëra me kolegë të punës e të gjitha këto lehtë mund të rezultojnë në dhunë fizike.⁸⁰

Më tutje, përveç pengesës së socializimit, shumë nga gratë e punësuar, privohen nga mundësia e ngritjes në detyrë, pikërisht për shkak të burrave të tyre. Këta të fundit, jo rrallë herë interferojnë me përpjekjet e grave të tyre për promovim, duke ndaluar pjesëmarrjen e tyre në trajnime apoudhëtime pune, me qëllim aftësimin e tyre profesional. Krahas kësaj, burrat shpeshherë janë shfaqur pengesë edhe e vazhdimin të arsimimit të grave pas martesës.⁸¹ Të gjitha këto mund të shpiejnë në papunësi dhe në shumë raste promovimin i këtyre grave në punë, kur të njëjtat veçse janë të punësuar.

2.3 Dhuna ekonomike gjatë dhe pas divorcit

Dhuna ekonomike është dëshmitari më i mirë se fatkeqësisht, një partner abuzues mund të ushtroj kontroll mbi viktimën, pa pasur domosdo nevojë

për prezencë fizike. Duke qenë kështu, përveç në bashkëjetesë e martesë, kjo dhunë mund të shfaqet edhe gjatë dhe pas divorcit,⁸² me ç'rast partneri vazhdon të ushtrojë kontroll, kryesisht përmes dëmtimit dhe vjedhjes së pasurisë së partneres, tjetërsimit të pasurisë së saj apo të përbashkët, si dhe shmangies së obligimeve financiare të mbajtjes së fëmijëve.⁸³ Lidhur me këtë, është gjetur se përafërsisht një në katër gra raportojnë dhunë ekonomike pas ndarjes.⁸⁴ Për ilustrim, njëra nga pjesëmarrëset e një studimi pohon se në momentin kur ajo kishte vendosur ta braktiste të shoqin, ky i fundit e kishte zbratur llogarinë e përbashkët bankare duke e lënë atë dhe fëmijët pa asnjë mjet financiar.⁸⁵

2.4 Cilët janë shkaktarët e dhunës ekonomike?

2.4.1 Mentaliteti

Përceptimet lidhur me pozitën dhe rolin e gruas në familje dhe shoqëri kanë ndikim të jashtëzakonshëm në (mos) praninë e dhunës në përgjithësi dhe dhunës ekonomike në veçanti.⁸⁶ Kështu, në vendet me ideologji të rrënjësuar patriarkale, dominojnë perceptimet ndaj burrave si "koka e familjës" dhe grave si "përgjegjëse parësore për përkujdesën e familjes dhe mbajtjen e shtëpisë". Një botëkuptim i tillë i ka trasuar në masë të madhe rrugën fenomenit të dhunës ekonomike, burra që nuk lejojnë gratë e tyre të punojnë jashtë shtëpisë dhe gra që sakrifkohen shkollimin dhe karrierën e tyre për tu përkujdesur për familjen. Kuptohet, të njëjtat mbesin të varura dhe të abuzuara ekonomikisht nga burrat e tyre. E njëjta logjikë e sakrificës së grave për familjen, mbetet prezente edhe kur ato mbërrijnë një moshë të shtyer dhe shoqëritë patriarkale presin kontributin e tyre në kujdesin ndaj shtëpisë dhe nipërve e mbesave, pa pagesë.⁸⁷

78 Ellie Butt, "Know Economic Abuse, 2020 Report," *Refuge*, (2020), fq. 39.

79 Sundari Anitha, "Understanding Economic Abuse Through an Intersectional Lens: Financial Abuse, Control and Exploitation of Women's Productive and Reproductive Labor," *SAGE Publications*, (2019), fq. 1868.

80 Po aty, fq. 1869.

81 Adriene Adams, Cris Sullivan, Deborah Bybee and Megan Greeson, "Development of the Scale of Economic Abuse," *SAGE Publications*, (2008), fq. 565.

82 = Surviving Economic Abuse, "Domestic Abuse Bill: The inclusion of economic abuse and the need for a post-separation economic abuse amendment," *SEA*, (2020), fq. 2. Shih: https://survivingeconomicabuse.org/wp-content/uploads/2021/01/SEA-briefing-DA-Bill-For-HL-Second-Reading_September-2020-FINAL-1.pdf.

83 UNSW Australia, "Responding to Economic Abuse." Shih: https://www.arts.unsw.edu.au/sites/default/files/documents/Issues_paper_2_Responding_to_economic_abuse.pdf.

84 Surviving Economic Abuse, "Domestic Abuse Bill: The inclusion of economic abuse and the need for a post-separation economic abuse amendment," *SEA*, (2020), fq. 1. Shih: https://survivingeconomicabuse.org/wp-content/uploads/2021/01/SEA-briefing-DA-Bill-For-HL-Second-Reading_September-2020-FINAL-1.pdf.

85 Ellie Butt, "Know Economic Abuse, 2020 Report," *Refuge*, (2020), fq. 39.

86 Economic Violence, fq. 369.

87 Nevena Petrusic, Natasa Todorovic, Milutin Vracevic and Brankica Jankovic, "Financial Abuse of Older Women in Serbia," *Journal of Elder Abuse and Neglect*, (2015), fq. 417.

2.4.2 Historia e mëparshme e dhunës në familje

Studimet kanë dëshmuar se të qenit pjesë e një ambienti të dhunshëm gjatë fëmijërisë rritë mundësinë e formimit të burrave të dhunshëm që dhunën e konsiderojnë mjet të zakonshëm të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve,⁸⁸ dhe grave që i ekspozohen dhunës për së dyti.⁸⁹ Deri diku, një gjë e tillë shpie edhe te internalizimi i dhunës nga gratë, në shkallën që shumë gra shpeshherë nuk dijnë as ta identifikojnë dhunën që ato e përjetojnë, meqë ajo ka qenë pjesë e “normalitetit të jetës së tyre në fëmijëri dhe mbetet pjesë e pandashme e jetës martesore. Prandaj, disave u merr kohë shumë të gjatë ta kuptojnë se ato janë viktimë e dhunës ekonomike. Në një prej hulumtimeve, një grua pohon se i'u deshën plot shtatëmbëdhjetë vjet për të kuptuar se ajo kishte qenë viktimë e dhunës ekonomike të ushtruar nga bashkëshorti dhe anëtarët e tjerë të familjes së tij.⁹⁰

Në shumë studime megjithëse gratë kanë mohuar të qenit viktimë e abuzimit ekonomik, përgjigjet e tyre sygjerorë se ato në fakt janë viktimë të kësaj dhune. Për më tepër, edhe pse shumica dërmuese e grave kundërshtojnë dhunën e çfarëdo forme, ekziston një përqindje e konsiderueshme që konsideron se dhuna është një e drejtë natyrale e burrave. Nisur nga kjo, një studim mbi dhunën ekonomike në Turqi pohon se në vitin 2003, 39.1% e grave të intervistuar, arsyetojnë dhunën fizike ndaj tyre në raste si djegie e ushqimit, shpenzim i panevojshëm i parave apo moskujdes i mjaftueshëm ndaj fëmijëve. Kjo përqindje, megjithëse është zvogëluar dukshëm, prapë ekziston dhe rreth 8.6% e grave të intervistuar në Turqi dhunën ndaj tyre e konceptojnë si normale.⁹¹

2.4.2 Niveli i arsimimit dhe puna

Ekspozimi i grave ndaj dhunës ekonomike gjen

ndërlidhje edhe me nivelet e arsimimit të grave. Hulumtimet kanë treguar se gratë me nivele më të larta të arsimimit kanë më shumë gjasa për të raportuar dhunën në përgjithësi dhe dhunën ekonomike në veçanti. Për dallim nga kjo, gratë me nivele më të ulëta të shkollimit, që shpesh çon në mungesë të të pasurit një punë dhe të ardhura financiare që derivojnë nga ajo, janë shumë më tepër viktimë të dhunës ekonomike.⁹² Në anën tjetër, mbase edhe më tepër se niveli i shkollimit të grave, në uljen e shkallës së pranishmërisë së dhunës ekonomike ndikon niveli i shkollimit të partnerëve të tyre.⁹³

2.4.3 Mungesa e njohurive rreth dhunës ekonomike

Termi dhunë ekonomike ende nuk është mjaftueshëm i njohur ndër gratë. Një studim dëshmon se shumica e grave në Mbretërinë e Bashkuar nuk kanë dëgjuar për konceptin e dhunës ekonomike asnjëherë përpara se ti nënshtroheshin pyetësorëve. Prandaj, përderisa disa nga subjektet e hulumtimit mohuan të kenë qenë viktimë të dhunës ekonomike, përkundër faktit se përgjigjet e tyre rezultojnë se kanë qenë viktimë e dhunës ekonomike, në mungesë të njohurive të mjaftueshme për këtë çështje ato nuk e kanë përceptuar veten si të tillë.⁹⁴

2.4.4 Kushtet e rënda ekonomike/varësia financiare

Varfëria përceptohet edhe si shkak por edhe si pasojë e dhunës ekonomike.⁹⁵ Për qëllim të këtij seksioni do të trajtohet aspekti i parë, respektivisht, varfëria si shkak i dhunës ekonomike.

Në bazë të vlerësimeve mbi 50% e popullësisë së varfër në botë përbëhet nga gratë.⁹⁶ Kjo bën që edhe dhuna ekonomike të jetë dhunë tipike drejtuar kësaj kategorie.⁹⁷ Deri më tani është vërtetuar se shumica e të identifikuarave me dhunë ekonomike vijnë nga

88 Omer Alkan, Senay Ozar and Seyda Unver, Economic violence against women: A case in Turkey, *PLoS ONE*, (2021), fq. 7.

89 Taner Akar et al. “The prevalence of domestic violence against women among a group of women: Ankara, Turkey,” *Journal of Family Violence*, (2010), fq. 459.

90 Truchero, “Economic violence, a form of domestic violence,” (2013), fq. 64.

91 Taner Akar et al. “The prevalence of domestic violence against women among a group of women: Ankara, Turkey,” *Journal of Family Violence*, (2010), fq. 459.

92 Omer Alkan, Senay Ozar and Seyda Unver, Economic violence against women: A case in Turkey, *PLoS ONE*, (2021), fq. 6.

93

94 Ellie Butt, “Know Economic Abuse, 2020 Report,” *Refuge*, (2020), fq. 29.

95 Olufunmilyao Fawole, “Economic Violence to Women and Girls: Is it receiving the necessary attention?” *University College Hospital, Ibadan, Nigeria*, fq. 170.

96 World Bank Blogs, “No, 70% of the world’s poor aren’t women, but that doesn’t mean overtly isn’t sexist,” (2018), shih: <https://blogs.worldbank.org/developmenttalk/no-70-world-s-poor-aren-t-women-doesn-t-mean-poverty-isn-t-sexist>.

97 Olufunmilyao Fawole, “Economic Violence to Women and Girls: Is it receiving the necessary attention?” *University College Hospital, Ibadan, Nigeria*, fq. 169.

ekonomi të dobëta shtëpiake, me gra dhe burra që punojnë për një rrogë shumë modeste apo që nuk punojnë fare. Në të kundërtën, edhe gratë që punojnë dhe kanë arritur deri diku një stabilitet financiar, preken nga dhuna por në nivele dukshëm më të ulëta.⁹⁸

Ndërlidhja në mes të varësisë financiare dhe rrezikut të abuzimit është vënë në pah edhe në studimet e viteve të 70'ta të shekullit të kaluar. Studiuesi Gelles arriti në përfundimin se gratë që mbajnë puna me paga më të ulëta kanë më pak gjasa t'i japin fund një marrëdhënieje abuzive.⁹⁹ Në këtë mënyrë, gjasat për të dalë nga një lidhje e tillë rriten/zvoglohen në proporcion me rritjen/zvogëlimin e varësisë financiare nga partneri. Po ashtu, është gjetur se niveli i varësisë financiare ka ndikim edhe në ashpërsinë e dhunës që përjetohet. Sa më e thellë varësia financiare ndaj partnerit, aq më e ashpër dhuna. Përveç kësaj, niveli i varësisë financiare ndikon në mundësinë të viktimës për të iniciuar procedura gjyqësore. Meqë këto të fundit implikojnë shpenzime, qofshin ato minimale, kjo dekurajon shumë gra nga ndërmarrja e hapave ligjorë kundër dhunës që përjetojnë.¹⁰⁰ Në shumë raste, pikërisht varësia financiare bën që gratë nga strehimoret e përkohshme të vendosin të kthehen përsëri te partnerët abuzivë nga të cilët kanë ikur. Në të kundërtën, dhe në mungesë të strehimoreve më afatgjata, ato rrezikojnë të mbesin rrugëve pa strehë.¹⁰¹

2.5 Ndërlidhja e dhunës ekonomike me format e tjera të dhunës

Argumentohet se rreth 85% e njerëzve që kanë përjetuar dhunë ekonomike kanë përjetuar po ashtu forma të tjera të dhunës duke përfshirë dhunë fizike,

psiqike dhe seksuale.¹⁰² Kjo është dëshmia më e mirë se dhuna ekonomike rrallëherë paraqitet si e vetme.¹⁰³

Dhuna ekonomike shpeshherë shpie në rritjen e tensioneve familjare lidhur me shpenzimet e bëra, prandaj shpejt mund të eskalojë në dhunë fizike.¹⁰⁴ Në raste të tjera, dhuna ekonomike e manifestuar si detyrim i partneres për të kërkuar para nga të afërmit, e pasuar me refuzimin e saj për ta bërë një gjë të tillë, po ashtu mund të shpie lehtë të ushtrimit i dhunës fizike. Në anën tjetër, për gratë e detyruara të kërkojnë lëmshë, tentimi për të hequr dorë nga një rutinë e tillë, shpesh gjjen si përgjigje dhunën e ashpër fizike.¹⁰⁵ Prandaj me shumë të drejtë vlerësohet se gratë që përjetojnë dhunë ekonomike janë pesë herë më tepër të predispozuar ndaj dhunës fizike në krahasim me ato që nuk abuzohen ekonomikisht.¹⁰⁶

2.6 Pasojat

Për dallim prej studimeve të shumta që në fokus kryesor kanë pasojat e lëna nga dhuna fizike, psiqike dhe seksuale, pak argumentohet për pasojat e dhunës ekonomike, përkundër faktit se këto pasoja janë të rënda.¹⁰⁷ Përveç se të mëdha, këto pasoja janë edhe shumë afatgjata.

Siç u theksua edhe më lartë, dhuna ekonomike rrallëherë qëndron e vetme. Përkundrazi, ajo mund të shoqërohet edhe me dhunë fizike, gjë që ndikon rëndë në shëndetin e viktimave. Por, edhe si e vetme dhuna ekonomike ka ndikim negativ në shëndetin fizik, e veçanërisht në atë mendor të viktimave. Në lidhje me këtë të fundit, hulumtimet vërtetojnë një lidhje të ngushtë në mes të stresit kronik të përjetuar nga mungesa e qasjes në para, ushqim, veshëmbathje dhe banim adekuat dhe

98 Omer Alkan, Senay Ozar and Seyda Unver, "Economic violence against women: A case in Turkey," *PLoS ONE*, (2021), fq. 6-7.

99 Richard Gelles, "Violence in the Family: A Review of Research in the Seventies," *National Council on Family Relations*, (1980), fq. 878-879.

100 Cynthia Sanders, "Economic Abuse in the Lives of Women Abused by an Intimate Partner A Qualitative Study," *Violence Against Women*, (2014), fq. 4-5.

101 Po aty, fq. 5.

102 Ellie Butt, "Know Economic Abuse 2020 Report," (2020), fq. 4.

103 Karni Krigel and Orly Benjamin, "From Physical Violence to Intensified Economic Abuse: Transitions between the type of IPV Over Survivors' Life Courses," (2020), fq. 3.

104 Olufunmilayo Fawole, "Economic Violence to Women and Girls: Is it receiving the necessary attention?" *University College Hospital, Ibadan, Nigeria*, fq. 172.

105 Karni Krigel and Orly Benjamin, "From Physical Violence to Intensified Economic Abuse: Transitions between the type of IPV Over Survivors' Life Courses," (2020), fq. 9.

106 Surviving Economic Abuse, "Domestic Abuse Bill: The inclusion of economic abuse and the need for a post-separation economic abuse amendment," *SEA*, (2020), fq. 1, shih: https://survivingeconomicabuse.org/wp-content/uploads/2021/01/SEA-briefing-DA-Bill-For-HL-Second-Reading_September-2020-FINAL-1.pdf.

107 Adriene Adams, Cris Sullivan, Deborah Bybee and Megan Greeson, "Development of the Scale of Economic Abuse," *SAGE Publications*, (2008), fq. 564.

simptomave të ankthit, depresionit, problemeve me disponim, temperament e pagjumësi.¹⁰⁸ I tërë ky stres i shkaktuar nga rrethanat abuzive, me raste ka çuar edhe në infarkt.¹⁰⁹ Pra, dhuna ekonomike së pari dëmton rëndë ekonominë e një personi si dhe lë gjurmë të mëdha në shëndetin fizik dhe mendor të të njëjtit.¹¹⁰

Dhuna ekonomike thëllon varësinë financiare të të atakuarës duke minimizuar mundësitë e saj për t'u shkëputur nga marrëdhënia abuzive. Qëndrimi në një lidhje abuzive, kushtëzuar nga varësia financiare, më tej cënon rëndë sigurinë e viktimave. Në këtë mënyrë, viktimat mbeten në mës të të qëndruarit në një lidhje abuzive dhe të larguarit drejt një të ardhme e cila, në mungesë të stabilitetit financiar, po ashtu mbetet e pasigurt.¹¹¹ Në lidhje me këtë, shumë gra, në veçanti ato me të ardhura të ulëta apo pa të ardhura, dekurajohen që në fillim nga nisja e një jete të re për vete dhe fëmijët e tyre. Në anën tjetër, gratë të cilat i nënshtrohen dhunës ekonomike, por gjithsesi kanë të ardhura më stabile dhe më të mëdha, kanë më shumë gjasa të fillojnë një jetë të re dhe të pavarur nga abuzuesit e tyre.¹¹²

Dhuna ekonomike qëndron edhe si barrierë ndaj mundësive të grave për të përparuar dhe siguruar mjetet e veta financiare. Në pamundësi për tu edukuar dhe rritur atraktivitetin e tyre në tregun e punës, shumë gra humbasin mundësinë e krijimit të një jete të dinjitetshme. Ndërsa ato që ia dalin të largohen nga ambienti i shtëpisë për të punuar, iu mundësohet që sadopak të kenë një kontroll mbi atë që fitojnë dhe të jenë më të guximshme për të nxjerrë vetveten dhe fëmijët e tyre nga varfëria.¹¹³ Vlen të theksohet

se dhuna ekonomike jo vetëm që dëmton interesin individual, por edhe atë të përgjithshëm, duke qenë se frika dhe pasiguria e shkaktuar nga e njëjta shterron produktivitetin e fuqisë punëtore dhe si rrjedhojë ka ndikim negativ në të pasurit e një fuqie punëtore produktive në interes të shtetit.¹¹⁴

Përveç kësaj, dhuna ekonomike dëmton rëndë besimin dhe guximin e grave të pamartuara, por që janë pjesë e një lidhjeje abuzive, për të ndërmarrë hapa drejt martesës.¹¹⁵ Në dritën e këtyre fakteve, pasojat e dhunës ekonomike janë trajtuar si të barabarta, e ndonjëherë edhe më të mëdha, në krahasim me ato që lënë format e tjera të dhunës.¹¹⁶ Një mori pjesëmarrësesh në hulumtime të ndryshme e kanë konfirmuar një gjë të tillë.¹¹⁷ Për më tepër, këto pasoja janë edhe mjaft afatgjate. Rimëkëmbja nga kriza ekonomike si pasojë e drejtpërdrejtë e dhunës ekonomike, mund të zgjasë shumë vite pas ndarjes. Këtu në veçanti bëjmë fjalë për borxhet në të cilat abuzuesit kanë zhytur partneret e tyre e të cilat kanë pak mundësi t'i paguajnë. Lidhur me këtë, vlerësohet se afër 60% e grave zhyten në borxhe si pasojë direkte e dhunës ekonomike.¹¹⁸

Së fundmi, përveç pasojave tek viktimat, dhuna ekonomike gjithashtu ndikon te të afërmit e viktimës, duke u shkaktuar atyre stres, konsumuar kohë, energji dhe resurse materiale. Kjo më së shumti për faktin se pas ndarjes, miqtë e në veçanti familja janë adresa e parë e kërkimit të ndihmës së shumicës prej grave të prekura nga dhuna ekonomike.¹¹⁹ Kjo më së lehti kuptohet në shoqërinë tonë kosovare, ku është plotësisht e vetëkuptueshme se një grua që largohet nga një

108 Omer Alkan, Senay Ozar and Seyda Unver, "Economic violence against women: A case in Turkey," *PLoS ONE*, (2021), fq. 3; Adriene Adams, Cris Sullivan, Deborah Bybee and Megan Greeson, "Development of the Scale of Economic Abuse," *SAGE Publications*, (2008), fq. 568.

109 Ellie Butt, "Know Economic Abuse, 2020 Report," *Refuge*, (2020), fq. 39.

110 Omer Alkan, Senay Ozar and Seyda Unver, "Economic violence against women: A case in Turkey," *PLoS ONE*, (2021), fq. 3.

111 Adriene Adams, Cris Sullivan, Deborah Bybee and Megan Greeson, "Development of the Scale of Economic Abuse," *SAGE Publications*, (2008), fq. 568.

112 Cynthia Sanders, "Economic Abuse in the Lives of Women Abused by an Intimate Partner: A Qualitative Study," *Violence Against Women*, (2014), fq. 24.

113 Olufunmilyao Fawole, "Economic Violence to Women and Girls: Is it receiving the necessary attention?" *University College Hospital, Ibadan, Nigeria*, fq. 172.

114 Po aty.

115 Omer Alkan, Senay Ozar and Seyda Unver, Economic violence against women: A case in Turkey, *PLoS ONE*, (2021), fq. 3.

116 Po aty, fq. 4.

117 Adriene Adams, Cris Sullivan, Deborah Bybee and Megan Greeson, "Development of the Scale of Economic Abuse," *SAGE Publications*, (2008), fq. 564.

118 Surviving Economic Abuse, "Domestic Abuse Bill: The inclusion of economic abuse and the need for a post-separation economic abuse amendment," *SEA*, (2020), fq. 1, shih: https://survivingeconomicabuse.org/wp-content/uploads/2021/01/SEA-briefing-DA-Bill-For-HL-Second-Reading_September-2020-FINAL-1.pdf.

119 Olufunmilyao Fawole, "Economic Violence to Women and Girls: Is it receiving the necessary attention?" *University College Hospital, Ibadan, Nigeria*, fq. 173.

lidhje abuzive kthehet te prindërit apo të afërmit e saj, ndërsa injorohet fakti se obligimin për mirëmbajtjen dhe sigurimin e jetesës së saj dhe fëmijëve të saj në radhë të parë e bartë ish-bashkëshortit, siç është edhe e rregulluar me ligj. Shpenzimet për sigurimin e jetesës së saj në raste të largimit nga lidhja apo martesë abuzive në këto raste i marrin përsipër prindërit apo të afërmit e saj, e kjo është ngarkesë edhe për ta.

Rikuperimi nga dhuna ekonomike, në rrethana të mungesës së mjeteve materiale, është mjaft i vështirë. Shumë nga viktimat gjejnë strehim të familjet e tyre të cilat në raste të caktuara mund tu ofrojnë vetëm qëndrim dhe përkrahje të përkohshme, por jo më shumë. Prandaj, shumë gra në rrugë e sipër, detyrohen të lënë në gjysmë çdo tentativë rikuperimi dhe të kthehen e t'i përshtaten lidhjes abuzive. Është gjetur se skenare të tilla janë tipike për gratë që vijnë nga familjet e zonave kryesisht rurale e më të mëdha në numër, por jo edhe në të ardhura.¹²⁰ Këto gra, përveç dhunës nga burrat e tyre, ballafaqohen edhe me stigmë shoqërore dhe rrezikun nga dhuna në familjen e tyre amë.¹²¹ Në një skenar më optimist, gratë që arrijnë të gjejnë punë relativisht të mirë, pas shpëputjes nga lidhja abuzive, ia dalin të rikuperohen më lehtë nga pasojat e dhunës ekonomike.¹²²

3. Adresimi i dhunës ekonomike në shtetet e jashtme

3.1 Australia

Australia është ndër të parat që ka përfshirë dhunën ekonomike në legjislacion. Në kuadër të saj, Tasmania e ka të kriminalizuar dhunën ekonomike si shkelje të veçantë,¹²³ në Seksionin 8 të *Aktit për Dhunën në Familje*, të nxjerrë në vitin 2004 dhe në fuqi prej vitit 2005.¹²⁴ Në këtë akt, krahas dhunës ekonomike është njohur edhe abuzimi emocional apo intimidimi. Për të dy këto forma të dhunës është paraparë dënimi më gjobë deri në 6000 dollarë apo privimi nga liria deri në dy vjet.¹²⁵ Më konkretisht, seksioni i sipërpërmendur vijon kështu:

“Një personit i ndaloheq që me qëllim që të kontrollojë ose frikësojë në mënyrë të paarsyeshme bashkëshortin/en ose partnerin/en e tij/saj ose t'i shkaktojë dëmtim mendor ose frikë, të ndërmarë një ose më shumë nga veprimet e mëposhtme:

(a) detyrimi i bashkëshortit/es ose partnerit/es të tij/saj për të hequr dorë nga kontrolli mbi pasuritë ose të ardhurat;

(b) tjetërsimi i pasurisë në pronësi (i) të përbashkët të personit dhe bashkëshortit/es ose partnerit/es; (ii) të bashkëshortit/es ose partnerit/es; ose (iii) të fëmiut, pa pëlqimin e bashkëshortit/es apo partnerit/es ose vetë fëmiut;

(c) privimi i bashkëshortit/es ose partnerit/es nga pjesëmarrja në vendimmarrje mbi shpenzimet e shtëpisë ose disponim të pasurisë së përbashkët;

(d) privimi i bashkëshortit/es ose partnerit/es së tij/saj nga qasja në asetet e përbashkëta financiare për qëllim të mbulimit të shpenzimeve të rëndomta të familjes;

120 Sundari Anitha, Understanding Economic Abuse Through an Intersectional Lens: Financial Abuse, Control and Exploitation of Women's Productive and Reproductive Labor, *SAGE Publications*, (2019), fq. 1869.

121 Po aty, fq. 1870.

122 Po aty.

123 Emma Batha, New UK law aims to end financial abuse in relationships. Can it work? *Thomson Reuters Foundation News*, (2021), shih: <https://news.trust.org/item/20210429151515-6tobl>.

124 Marilyn McMahon and Paul Mcgoerry, "Criminalizing emotional abuse, intimidation and economic abuse in the context of family violence: The Tasmanian experience," *University of Tasmania Law Review*, (2017), fq. 1-2.

125 Po aty, fq. 7.

(e) tërheqja, ose kërcënimi për të tërhequr, mbështetjen e nevojshme financiare për mbajtjen e bashkëshortit/es, partnerit/es ose fëmiut.”

Pra, me këtë seksion, Tasmania ka ndëshkuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë veprimet me karakter kontrollues dhe detyrues.¹²⁶ Përkundër këtij fakti, është vërejtur një hezitim në denoncimin e rasteve të dhunës ekonomike. Deri në vitin 2015 në Tasmani nuk është evidentuar asnjë rast i tillë,¹²⁷ ndërsa viti 2016 përbën kthesë revolucionare në këtë aspekt. Në të njëjtin vit, është iniciuar padi për dhunë ekonomike, padi e cila do të elaborohet më në detaje në seksionin 3.4 të këtij kapitulli.

Krahas, Tasmanisë, edhe Queensland ka njohur shprehimisht dhunën ekonomike në të ashtuquajturin “*Domestic and Family Violence Protection Act*,” të nxjerrë në vitin 2012. Fillimisht, në Seksionin 2 (8) (c), Akti në fjalë përcakton se dhuna në familje manifestohet ndër të tjera edhe në formë të dhunës ekonomike.¹²⁸ Në pikën 12 të Seksionit 2, Akti definon detajisht dhunën ekonomike:

“Dhuna ekonomike nënkupton sjelljen detyruese, mashtruese dhe kontrollit të paarsyeshëm ndaj një personi, në formë të:

a.) mohimit të autonomisë financiare që personi do ta kishte në mungesë të abuzimit;

b.) tërheqjes apo kërcënimit për të tërhequr ndihmën financiare, të nevojshme për të realizuar shpenzimet e arsyeshme të jetesës së personit të abuzuar apo fëmiut, sidomos kur personi në fjalë apo fëmiu është në varësi financiare të plotë apo të pjesërisht nga personi që ushtron kontroll.”¹²⁹

Në të njëjtin instrument janë dhënë edhe shembuj të dhunës ekonomike, që variojnë nga detyrimi i një personi për të hequr dorë nga kontrolli i të hyrave dhe

aseteve, te detyrimi për të nënshkruar një prokurë që ia mundëson personit abuziv kontrollin e mjeteve financiare të të abuzuarit. Shembuj të tjerë përfshijnë: detyrimin për të nënshkruar kontratë mbi blerjen e gjëseneve apo shërbimeve, detyrimin për të hyrë në kredi, ndalimi për të kërkuar apo mbajtur punë etj.¹³⁰

3.2 Mbretëria e Bashkuar

Që nga viti 2015, Uellsia dhe Irlanda ndëshkojnë sjelljet kontrolluese dhe detyruese në atë që njihet si “*Serious Crime Act*.” Këto sjellje janë tipike për dhunën ekonomike meqë e njëjta manifestohet pikërisht përmes tyre.¹³¹ Kështu, dispozita 76 e aktit të përmendur thekson se veprimet cilësohen si kontrolluese dhe/apo detyruese kur një person ushtron kontroll të vazhdueshëm mbi personin tjetër, me të cilin kanë apo kanë pasur bashkëjetesë/lidhje, duke e ditur se ky detyrim/kontroll ka ndikim serioz në personin mbi të cilin ushtrohet.¹³² Dhunën ekonomike si formë të veçantë të dhunës e ka njohur edhe Irlanda në Domestic Abuse Bill. Në këtë rregullim ligjor definohet dhuna ekonomike si vijon:

1.4. “*Abuzim ekonomik*” nënkupton çdo sjellje që ka ndikim vështirësues të theksuar në mundësinë e personit B që të

a.) fitojë, përdorë apo mbajë para apo ndonjë lloj tjetër të pasurisë, ose

b.) marrë mallëra dhe shërbime.”¹³³

3.3 India

Një definim interesant të dhunës ekonomike e ka ofruar India, ku në legjislacionin e gjejmë në Nenin 3 të Kapitullit 2 të instrumentit të quajtur “*The Protection of Women from Domestic Violence Act 2005*.” se dhuna ekonomike përfshin:

(a) privimin nga të gjitha apo disa prej burimeve financiare të cilat personi i dëmtuar i gëzon në bazë të ligjit, zakonet

126 Parliament of Australia, “Inquiry into family, domestic and sexual violence, Submission 31,” *Women’s Legal Service Tasmania*, (2020), fq. 5.

127 Sentencing Advisory Council, “Sentencing of Adult Family Violence Offenders Final Report No. 5,” *Tasmania*, (2015), fq. 26.

128 Domestic and Family Violence Protection Act 2012, fq. 15, Dispozita 2 (8) (C).

129 Po aty, Dispozita 2 (12).

130 Po aty, fq. 19, Dispozita 2 (12).

131 Human Rights Watch, “Commentary on the Draft law on Anti-Domestic Violence in Iraq, (2017), shih: <https://www.hrw.org/news/2017/03/19/commentary-draft-law-anti-domestic-violence-iraq>.

132 UK Parliament, Serious Crime Act 2015, Seksioni 76, Shih: <https://www.legislation.gov.uk/ukpga/2015/9/contents/enacted>

133 UK Parliament, Domestic Abuse Act 2021, Seksioni 1 (4), Shih: <https://www.legislation.gov.uk/ukpga/2021/17/section/1/enacted>.

apo ndonjë urdhri të një gjykate ose mjete financiare të cilat personi i dëmtuar i kërkon nga nevoja, duke përfshirë por pa u kufizuar në nevojat shtëpiake, nevojat personale të personit të dëmtuar dhe fëmijëve të saj;

(b) asgjësimin e gjëseneve shtëpiake, **tjetërsimin e pasurive qoftë të luajtshme ose të paluajtshme, sendeve me vlerë, aksioneve, letrave me vlerë, obligacioneve dhe të ngjashme, në të cilat personi i dëmtuar ka interes ose ka të drejtë t'i përdorur në bazë të marrëdhënies së përbashkët [...].**¹³⁴

3.4 Praktika Gjyqësore

Deri në ditët e sotme, gjykatat vendore nuk kanë regjistruar ndonjë iniciim të padisë kundër dhunës ekonomike. Aspak më mirë nuk qëndrojnë as forumet e jashtme të drejtësisë. Përrjashtimisht, siç u përmend më lartë, një iniciim ka ndodhur në Tasmani në vitin 2016, dhe i njëjti ka të bëjë me një person, i cili është akuzuar nga gruaja e tij për dhunë ekonomike të ushtruar në disa forma. Fillimisht paditësja ka akuzuar burrin e saj për privim nga qasja në mjetet e përbashkëta financiare që, përgjatë martesës 13 vjeçare, ka kapur shifrën 500,000 dollarë, por fundi i kësaj martese e ka gjetur llogarinë e përbashkët bankare me vetëm 10,000 dollarë. 90% e parave të përbashkëta ishin shpenzuar në mënyrë të njëanshme nga i akuzuari, i cili po ashtu ishte akuzuar për moslejimin e paditëses për të hyrë në marrëdhënie pune.¹³⁵

Meqë si formë e dhunës shumë vonë është futur në legjislacion, ende ka mungesë të rasteve në praktikë, e kjo edhe për arsye se vetë gratë nuk janë mjaftueshëm të informuara për të drejtat e tyre. Në këtë kontekst, nevojitet një angazhim më i madh për vetëdijësimin e grave, por sidomos një definim i saktë e termit të dhunës ekonomike, i cili do të ishte gjithëpërfshirës dhe i qartë, në mënyrë që të mundësohet edhe ndjekja e rasteve të dhunës ekonomike në praktikën gjyqësore.

4. Dhuna Ekonomike në Kontekstin Kosovar

4.1 Identifikimi i dhunës ekonomike

Deri më tani, në arenën ndërkombëtare janë realizuar disa studime me fokus identifikimin e dhunës ekonomike, por fare pak të tilla janë realizuar në Kosovë.

Me qëllim të arritjes së këtij objekti, studimet në përgjithësi janë fokusuar në disa pyetje kryesore të cilat i janë parashtruar të intervistuarave. Në një prej hulumtimeve, autori është fokusuar në tri pyetje qëndrore. Së pari, të intervistuarat janë pyetur se a kanë pasur mundësi t'i shpenzojnë paratë që i kanë fituar vetë? Së dyti, a ju a ka marrë burri apo partneri fitimin apo kursimet kundër vullnetit? Së fundmi, a ka refuzuar partneri t'u jap para për qëllim të mbulimit të shpenzimeve shtëpiake, edhe pse ka pasur mundësi të ju jap? Vlen të theksohet se gratë me të ardhura vetanake kanë pasur tri herë më shumë gjasa për tu përgjigjur me "jo" në këto pyetje, për dallim nga gratë e papuna. E njëjta vlen edhe për statusin martesor, me ç'rast përgjigje negative janë dhënë nga gratë beqare, për dallim nga të martuarat të cilat kishin më shumë gjasa për të konfirmuar ekzistimin e këtyre rrethanave që shpiejnë në dhunë ekonomike.

Në disa studime të tjera, që po ashtu mund të shërbejnë si model për identifikimin e dhunës ekonomike në Kosovë, janë shtruar një mori pyetjesh më të detajizuara, të cilat i gjeni në tabelën e bashkëngjitur në shtojcën 1 të hulumtimit. Tutje, disa nga studimet konstatojnë ekzistimin e dhunës ekonomike nëpërmjet shpeshtësisë së përjetimit të saj nga viktimat. Për shembull, një nga organizatat britanike më në zë në çështjet e ngritjes së vetëdijësimit dhe adresimit më efektiv të abuzimit ekonomik, respektivisht "Surviving Economic Abuse-SEA," propozon një formular me 12 pyetje/rrethana të grupuara në tri kategori: kontroll ekonomik, eksploatim ekonomik dhe sabotim i punësimit, me qëllim të identifikimit të dhunës ekonomike. Organizata në fjalë, u kërkon pjesëmarrësve që të vlerësojnë nga 1 (kurrë)

134 The Protection of Women from Domestic Violence Act, 2005, Ministry of Law and Justice of India, New Delhi (2005), 3 (d) (iv).

135 Edith Bevin, Tasmanian man accused of preventing wife from making decisions, accessing joint accounts, (2016), shih: <https://www.abc.net.au/news/2016-08-01/tasmanian-man-prosecuted-for-alleged-economic-abuse/7679922>.

deri në 5 (mjaft shpesh) shpeshësinë e përjetimit të këtyre rasteve përgjatë 12 mujorit të kaluar.¹³⁶

Në anën tjetër, për qëllime të identifikimit të abuzimit financiar të të moshuarve, studimet rekomandojnë se një ndër shenjat që sugjeron ekzistimin e kësaj forme të dhunës ekonomike të kjo kategori janë falsifikimi i nënshkrimeve në dokumente financiare, faturat e papaguara si dhe transformimi i befasishtëm i burimit të shpenzimeve, ndërrimi i papritur i vullnetit të shprehur në trashëgimi dhe dokumente të tjera financiare, e kështu me rradhë.¹³⁷

4.2 Baza Ligjore

4.2.1 Kodi Penal i Republikës së Kosovës

Krahas Ligjit Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, si bazë ligjore më specifike për adresimin e dhunës, edhe Kodi Penal i Republikës së Kosovës përmban disa dispozita relevante për këtë qëllim. Fillimisht, në Nenin 248 të Kodit Penal, trajtohet dhuna në familje. Paragrafi 1 i këtij neni bën referencë eksplicite ndaj aspektit ekonomik të dhunës dhe vijon kështu:

*"1. Kushdo që e kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose **ekonomik** me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në 3 (tre) vjet.¹³⁸"*[theksim i shtuar].

Gjithashtu, edhe në paragrafin 3 të po të njëjtit nen parashihen masa ndëshkuese për ata që shkaktojnë dhunë ose keqtrajtim fizik, psikologjik, seksual ose ekonomik. Pra, edhe në këtë paragraf, është njohur keqtrajtimi ekonomik dhe atë shprehimisht: *"3. Çdo anëtar i familjes që ushtron dhunë ose keqtrajtim fizik, psikologjik, seksual ose **ekonomik** ndaj anëtarit tjetër të familjes së tij/saj, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet."¹³⁹* [theksim i shtuar].

Për më tepër, në nënparagrafin 3.2 parashihet që

"Dhuna në familje, dhuna fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike, për nevojat e këtij kodi do të jetë e njëjtë siç është përkufizuar në dispozitën e nenit 2, nën paragrafi 1.2. të Ligjit nr. 03/L-182 për mbrojtje nga Dhuna në Familje."¹⁴⁰

Përkundër faktit se Kodi penal referon në Ligjin Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për përkufizimin e dhunës në familje, asaj fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike, është me rëndësi të theksohet se as në Kod Penal e as në Ligjin në fjalë, nuk definohet në mënyrë shprehimore e as të nënkuptuar se cka në fakt përfshin termi dhunë ekonomike. Një mangësi të tillë nuk e gjejmë vetëm te legjislacioni vendor, por siç u përmend edhe më lartë edhe Konventa e Stambollit, përkundër natyrës revolucionare në njohjen e dhunës ekonomike si formë të dhunës në familje dhe ndaj grave, ka dështuar ta definojë dhunën ekonomike me gjithë format dhe masat ndëshkuese ndaj saj. Në seksionin e radhës do të elaborohet më në detaje Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, gjithashtu do të prezantohen edhe propozimet në lidhje me iniciativën e nxjerrjes së Ligjit të ri për Mbrojtjen dhe Parandalimin nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave, me qëllim të adresimit më konkret të dhunës ekonomike.

Një rrafsh tjetër potencial i trajtimit të dhunës ekonomike në kuadër të Kodit Penal, mund të konsiderohet Neni 165 (6) (2) që rregullon çështjen e shfrytëzimit në atë mënyrë që i njëjti të përfshijë edhe shfrytëzimin e lëmshës së të tjerëve.¹⁴¹ Sic është theksuar në pikën 2.2.5.1 të këtij punimi hulumtimet, në mes të tjerash, orientojnë (sygjerojnë?) që detyrimi për të kërkuar lëmshë të konsiderohet si formë të dhunës ekonomike.

Më tutje, neni 323 i Kodit Penal rregullon mashtrimin dhe nga definimi i të njëjtit koncept në paragrafin 1, derivon se ky nen ka poashtu potencial të përdoret si një nga bazat ligjore për trajtimin e dhunës ekonomike, meqë mashtrimi siç parashihet në këtë nen përfshin:

136 Amanda Mathisen, Judy Postmus, Sarah McMahon, "Measuring Abusive Behaviours: Is Economic Abuse a Unique form of abuse?" *Journal of Interpersonal Violence*, (2013), fq. 192.

137 Get the Facts on Elder Abuse, (2021) shih: <https://www.ncoa.org/article/get-the-facts-on-elder-abuse>.

138 Kodi Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 248(1).

139 Po aty, Neni 248 (3).

140 Po aty, Neni 248 (3)(2).

141 Po aty, Neni 165 (6) (2).

*"1. Përveç siç parashihet në nenin 324 të këtij Kodi, **kushdo që me anë të paraqitjes së rreme të fakteve apo duke fshehur faktet ose në çfarëdo mënyre tjetër mashtruese dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo personin tjetër, ose për t'i shkaktuar dëm material personit tjetër, e mashtron apo vazhdon lajthimin e personit tjetër dhe me këtë e nxit një person që të kryej apo të mos kryej një veprim, i cili rezulton në dëm material të pasurisë së tij/saj apo të pasurisë së personit tjetër ose rezulton në dobi pasurore të kundërligjshme, për veten apo personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.**"¹⁴² [theksim i shtuar].*

Lidhur me këtë, dhuna ekonomike shpeshherë karakterizohet me mashtrim. Një ndër format e dhunës ekonomike, që realizohet pikërisht përmes mashtrimit, konsiston në fshehjen e të hyrave nga anëtari i familjes në mënyrë që ky/kjo e fundit t'i mbulojë shpenzimet familjare. Krahas kësaj, edhe hyrja në kredi në emër të partneres përmes falsifikimit të nënshkrimit apo lënjes në hipotekë të pasurisë së saj, mund të ketë elemente të mashtrimit.

Më tutje, dhuna ekonomike plotëson edhe elementet e veprës penale në vazhdim, siç është paraparë në Nenin 77 (Dënimi për veprat penale në vazhdim) të Kodit Penal. I njëjti përcakton se:

*"1. Vepra penale në vazhdim përbëhet nga disa **vepra të njëjta ose të ngjashme** të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes, dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy prej kushteve në vijim:*

1.1. viktimës së njëjtë të veprës penale;

1.2. objekti i njëjtë i veprës;

1.3. shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore;

1.4. vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale; ose

1.5. dashja e njëjtë e kryesit."¹⁴³ [theksim i shtuar].

Meqenëse, dhuna ekonomike ka viktimën e njëjtë të veprës penale që në shumicën e rasteve është gruaja si bashkëshorte, e në disa raste nënë, objektin e njëjtë që konsiston në resurset materiale të gruas si dhe dashjen e njëjtë të kryesit për të ushtruar kontroll dhe krijuar varësi financiare në mënyrë që të pengojë viktimën nga shkëputja e lidhjes abuzive, mund të pretendohet me të drejtë se dhuna ekonomike është vepër penale në vazhdim.

Një prej rasteve tipike të dhunës ekonomike që fillon gjatë martesës, por në veçanti gjatë dhe pas divorcit, e që vërteton edhe njëherë karakterin unik të kësaj forme të dhunës që mund të ushtrohet edhe pa praninë fizike të kryerësit, është shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës, e rregulluar me nenin 245 të Kodit Penal. Këtu, bëjmë fjalë kryesisht për shmangien nga përmbushja e obligimit të patjetërsueshëm të ushqimisë, i rregulluar me Ligjin Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 06/L-077. Neni 282 (1) dhe Neni 298 i Ligjit të sapopërmendur thekson se bashkëshorti është i detyruar t'i jap mbajtje financiare bashkëshortit tjetër,¹⁴⁴ në veçanti kur bashkëshorti i cili mbahet financiarisht nuk është i aftë të punojë, ose për arsye të tjera nuk mund të punësohet.¹⁴⁵ Në seksionin 2 të këtij hulumtimi u ilustrua edhe përmes hulumtimeve dhe rasteve të përfshira në to se privimi nga fondet e mjaftueshme për mbajtjen e vetës dhe fëmijeve është një ndër format më tipike të dhunës ekonomike. Këtu rikujtojmë se shumë bashkëshortë shkelin këtë obligim në mënyrë flagrante, kur të njëjtit u mohojnë grave të drejtën për të blerë ushqim të mjaftueshëm, veshmbathje e mjete higjienike të domosdoshme për familjen.¹⁴⁶ Kjo vjen në shprehje më së shumti në rastet kur kryerësit e veprave penale përfshihen në lojëra të fatit dhe paratë për shpenzimet familjare i orientojnë pikërisht në këto lojëra. Ngjashëm me këtë, bashkëshortët e varur nga alkooli dhe droga poashtu shmangin obligimet familjare duke shkelur obligimin e tyre. Ka edhe raste kur shmangia bëhet me qëllim dhe me dashje, përkundër që ekzistojnë mundësitë

142 Po aty, Neni 323.

143 Po aty, Neni 77.

144 Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 06/L-077., Neni 282 (1).

145 Po aty, Neni 298.

146 Ellie Butt, "Know Economic Abuse, 2020 Report," *Refuge*, (2020), fq. 34.

financiare për të mirëmbajtur ish-bashkëshorten dhe fëmijët, por që personat qëllimisht ndërrojnë punë, apo falsifikojnë dokumente për të paraqitur se kanë një pagë më të vogël, me qëllim që të mos i kryejnë obligimet financiare ndaj ish-bashkëshortes dhe fëmijëve të përbashkët. Natyrisht, kjo përbën dhunë ekonomike dhe mashtrim dhe do të duhej të ndjeket nga organet e rendit dhe ligjit.

Më tutje, neni 290 (1) Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 06/L-077, normon obligimin e mbajtjes financiare ndaj fëmijëve në moshë të mitur,¹⁴⁷ ndërsa neni 209 (2) zgjeron obligimin e mbështetjes financiare të fëmijëve të moshës 18-26 vjeç.¹⁴⁸ Përkundër kësaj, divorci, nga disa njerëz pa të drejtë interpretohet si ndërprerje e këtij obligimi. Pikërisht me këtë fillon dhuna ekonomike gjatë dhe pas divorcit ku (ish)bashkëshortët shpeshherë përmes fshehjes së të dhënave financiare, ndërrimit të adresës e formave të tjera, shmangin mbajtjen financiare apo edhe qasjen në pasuri dhe pronë. Lidhur me këtë, Neni 293 i të njëjtit ligj përcakton se:

“Prindi, të cilit i është hequr kujdesi prindëror nuk lirohet nga detyrat për t’i mbajtur fëmijët e tij.”¹⁴⁹
[theksim i shtuar].

Gjithashtu, Neni 309 (1) vijon;

“(1) Detyrimin për ushqimi së pari e mban ish-bashkëshorti.”¹⁵⁰

Pra, refuzimi i mbajtjes financiare të fëmijëve gjatë dhe pas divorcit bie në kundërshtim të hapur jo vetëm me Nenin 245 të Kodit Penal por edhe me dispozitat e cekura të Ligjit Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 06/L-077 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës.

Më tej, një tjetër dispozitë e Kodit Penal, me rëndësi për adresimin e dhunës ekonomike është Neni 313 që rregullon vjedhjen. Siç u përmend në nënparagrafin 2.7, dhuna ekonomike konsiston edhe në dëmtimin e pasurisë së bashkëshortës që në mes të tjerash manifestohet edhe me vjedhjen e pasurisë së bashkëshortes apo ish bashkëshortes. Gjithashtu, në pikën 2.2.6 të këtij hulumtimi, u përmend se vjedhja e parave nga partnerja ka edhe karakter eksploatues që sipas një studimi, prek afër 38% të grave që abuzohen ekonomikisht.¹⁵¹ Me nenin 313 (Vjedhja) në paragrafet (1) dhe (2) të Kodit Penal përcaktohet se:

“1. Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) Euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

2. Nëse vlera e pasurisë së vjedhur është më pak se pesëdhjetë (50) euro, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.”

Kësisoj, dhuna ekonomike e manifestuar përmes marrjes së parave në vlerë prej 50 e më shumë, eurosh pa dijeninë e bashkëshortes, mund të ndëshkohet përmes kësaj dispozite të Kodit Penal.

Së fundmi, një tjetër rrafsh të trajtimit të dhunës ekonomike përmes Kodit, e gjejmë në Nenin 321 nën titullin *“Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”*. Lidhur me këtë, paragrafi 1 i nenit në fjalë parasheh dënimin me gjobë apo me burgim deri në një vit për personin që asgjëson, dëmton apo e bën të papërdorshme pasurinë e tjetrit,¹⁵² ndërsa dënimi mund të shkojë nga 1 deri në 3 vjet burgim, për dëmin që tejkalon shumën prej pesëmijë (5,000) euro.¹⁵³ Këtu, vlen të ritheksohet ajo çfarë u argumentua në pikën 2.2.6 të këtij punimi lidhur me dëmtimin e pasurisë si formë të dhunës ekonomike. Kjo e fundit manifestohet me dëmtimin e paisjeve shtëpiake, veturës, prishjen e sistemit elektrik e

147 Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 06/L-077, neni 290 (1)

148 Po aty, Neni 290 (2).

149 Po aty, Neni 293).

150 Po aty, Neni 309 (1)

151 Michael Anderson dhe të tjerët, “Why doesn’t she just leave?” A Descriptive Study of Victim Reported Impediments to Her Safety,” *Journal of Family Violence*, (2003), fq. 153.

152 Kodi Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 321 (1).

153 Po aty, Neni 321 (2).

të ngrohjes. Të gjitha këto implikojnë shpenzime shtesë për viktimën, për t'i rregulluar apo zëvendësuar ato.

4.2.2 Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje

Neni 3 i Ligjit Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, i miratuar në vitin 2010 definon dhunën në familje si:

“Një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bëjnë një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në:

1.2.1. përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes;

1.2.2. çdo veprim tjetër i një anëtari të familjes që mund të shkaktojë apo kanos, se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike;

1.2.3. shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit;

1.2.4. sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat;

1.2.5. ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë;

1.2.6. përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përruljes së personit tjetër;

1.2.7. marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual;

1.2.8. kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër;

1.2.9. dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë;

1.2.10. vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike;

1.2.11. hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër;

1.2.12. rrëmbimi.”¹⁵⁴

154 Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Neni 3 (1).

155 Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, 12 Prill 2011, Neni 3 (b); Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Amandamenti nr. 26.

156

Siç mund të vërehet, Ligji në fjalë nuk rregullon në mënyrë eksplicite dhunën ekonomike, por në nënparagrafin 1.2.10 përmban një referencim të drejtpërdrejtë megjithëse jo të mjaftueshëm, ndaj asaj që mund të themi se përbën dhunë ekonomike. Përkundër këtij fakti, nga një interpretim më i gjerë i këtij neni, derivon se fenomeni i dhunës ekonomike mund të trajtohet edhe në kuadër të nën-nënparagrafit 1.2.2. Meqë edhe vetë Konventa e Stambollit që tashmë është integruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, aktualisht e trajton dhunën ekonomike në kuadër të dhunës psikologjike, mund të konkludojmë se elemente të dhunës ekonomike gjejmë edhe te ky nën-nënparagraf.¹⁵⁵

Më tutje, elementet e shkakimit të ndjenjës së frikës dhe cënimit të dinjitetit të përcaktuara me nën-nënparagrafin 1.2.3, përveç në format e tjera të dhunës, i gjejmë të pranishme edhe në dhunën ekonomike.¹⁵⁶ Prandaj, në kuadër të kornizës ekzistuese ligjore, dhuna ekonomike mund të trajtohet edhe në kuadër të këtij nënparagrafi. Në seksionin e parë, gjithashtu u përmend se kryerësi i dhunës ekonomike, në të shumtën e rasteve, ka për qëllim përruljen e viktimës përmes përsëritjes së vazhdueshme të veprimeve abuzive, gjë që mund të çenoj dinjitetin e viktimës.

Së fundmi, nën-nënparagrafi 1.2.9 parasheh se një ndër format e dhunës në familje është edhe dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë. Lidhur me këtë, në pikën 2.2.7 të këtij hulumtimi është demonstruar se dëmtimi i pasurisë së gruas dhe familjës është një nga format më të shpeshta të manifestimit të dhunës ekonomike, që kryesisht konsiston në vjedhjen dhe dëmtimin e posedimeve si veturës, orëdive shtëpiake, paisjeve elektrike e elektronike. Për këtë arsye, dhuna ekonomike edhe pse jo e referencuar direkt, mund të trajtohet edhe përmes nën-nënparagrafit 1.2.9 të Nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.

4.3. Propozimet për Ndryshimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje

4.3.1 Propozimet e organizatës jo-qeveritare INJECT

Në vitin 2018 organizata jo-qeveritare INJECT ka kërkuar në Komisioni për të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Kosovës që të inicohet ndryshimi i

Ligjit Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje. Në vitin 2019, ky Komision ka filluar punimet , me ç'rast organizata e mirënjohur në fushën e drejtësisë dhe barazisë gjinore, Iniciativa për Drejtësi dhe Barazi INJECT ka dërguar dhe paraqitur në grupet punese propozimet dhe komentet e saj. Këto komente kanë adresuar fillimisht mungesën e një definicioni gjithëpërfshirës të dhunës ekonomike në ligj që i hap rrugë ndëshkueshmërisë së kësaj forme të dhunës. Lidhur me këtë, INJECT ka propozuar që definimi i dhënë më poshtë të inkorporohet në kuadër të Nenit 2 të Ligjit. Definicioni në fjalë vijon kështu:

“1.2. Dhuna ekonomike është mohimi i qasjes në të drejtën e barabartë në pasurinë e përbashkët bashkëshortore, fshehja e pasurisë bashkëshortore nga anëtari i familjes, ushtrimi i pushtetit mbi anëtarin tjetër të familjes duke shfrytëzuar mjetet financiare, mbajtja nën presionin ekonomik të anëtarit të familjes përmes ushtrimit të presionit ekonomik, pengimi për të punuar, shpenzimi i mjeteve financiare në dispozicion të familjes pa marrëveshje me bashkëshortin/en, mospërbushja e detyrimeve të alimentacionit dhe mbajtjes financiare (ushqimisë). Dhuna ekonomike është vepër penale, e cila nëse dëshmohet, dënohet sipas Kodit Penal.”

Më tutje, INJECT ka rekomanduar që në kuadër të Nenit 3 të Ligjit, të sigurohet mbështetje financiare ndaj viktimës gjatë kohëzgjatjes së procesit gjyqësor. Sipas INJECT fondet për këtë duhet të merren automatikisht nga paga e kryerësit të dhunës ekonomike. INJECT thekson se një gjë e tillë pengon shmangien e obligimit të ushqimisë ndaj (ish) bashkëshortes dhe fëmijëve. Gjithashtu sipas INJECT e njejta gjë do t'a lironte viktimën nga koha, energjia dhe financat e shpenzuara në ngritjen e një kallëzimi penal për shmangien e obligimit të ushqimisë. Në disa raste, respektivisht

kur gjykata ka dyshim të bazuar apo edhe dëshmi për ekzistencën e shkeljeve të detyrimeve të ushqimisë, apo të detyrimeve familjare, INJECT propozon që *ex officio* të ngritet padi ndaj kryerësit të dhunës ekonomike, sepse shumë individë nuk i njohin të drejtat e tyre sa duhet, aq më pak kur bëhet fjalë për dhunën ekonomike si formë më pak e njohur, në krahasim me format e tjera të dhunës.

Krahas këtyre, INJECT ka ngritur shqetësimin e organizatës lidhur me mungesën e demarkimit të qartë të kompetencave të policisë dhe prokurorisë apo gjykatave si dhe mënyrën e komunikimit të tyre. Në këtë pikë, INJECT potencon se, në versionin e plotësuar dhe ndryshuar të Ligjit, duhet të përcaktohet domosdoshmëria e transparencës së komunikimeve mes policisë dhe prokurorisë apo gjykatave, karshi viktimës. Për më tepër INJECT ka kërkuar që ligji të përcaktojë se një komunikim i tillë, qoftë lidhur me procedimin e rastit apo urdhërin mbrojtës, duhet të realizohet me shkrim në mënyrë që të mund të evidentohet a ka qenë adekuat trajtimi dhe procedimi i rastit dhe që shkeljet eventuale institucionale të mund të vërtetohen.

4.3.2 Procesi i ndryshimit të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, i cili vepron në kuadër të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka filluar nxjerrjen e një ligji të ri për mbrojtjen nga dhuna në familje. Versioni i ri ka definuar dhunën ekonomike por ky definim është relativisht i mangët. I njëjti e normon dhunën ekonomike si:

“mohimin e qasjes apo kontrollit të burimeve bazike, përmes kufizimit të mjeteve të domosdoshme për jetë, mohimin e qasjes në shërbime mjekësore, shkollim apo punësim, apo formave të tjera të presionit me qëllim të mbajtjes së një personi në pozitë të varur ekonomike.”¹⁵⁷

Në bazë të të gjeturave në këtë hulumtim të bazuar në legjislativën ekzistuese në vendet tjera dhe studimet e bëra në këtë drejtim, dhuna ekonomike është shumë më tepër së mohimi i qasjes në burime bazike apo pengim

157 Shih: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=236>.

për tu shkolluar e punësuar. Ajo po ashtu konsiston edhe në elemente të tjera me rëndësi për kontekstin kosovar, ndër të cilat më me rëndësi është tjetërsimi i pasurisë së përbashkët gjatë martesës e veçanërisht gjatë divorcit. Pasuria e bashkëshortëve, në disa raste, mund të kap vlerë shumë më të madhe monetare se sa thjeshtë të mjaftueshme për mjete bazike. Në këtë pasuri, gratë mund të kenë kontribuar direkt me mjete financiare, apo të kenë dhënë kontributin e tyre jo-monetar, në formë të kryerjes së punëve shtëpiake, ofrimit të kujdesit ndaj fëmijëve etj. Lidhur me këtë aspekt, Neni 1 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës përcakton se, pasuri e fituar me kontribut të përbashkët gjatë martesës konsiderohet edhe:

“2.2. ndihma e bashkëshortit e afruar bashkëshortit tjetër, siç është kujdesi për fëmijët, udhëheqja e punëve të shtëpisë, përkujdesja dhe mirëmbajtja e pasurisë, si dhe çfarëdo forme tjetër e punës dhe e bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.”

Pra, duke qenë se korniza ligjore e Republikës së Kosovës është mjaft e avancuar, në njohjen e kontributit jo-monetar të grave në pasurinë e përbashkët familjare, në çdo rast të divorcit gratë kanë të drejtën e pjesës së tyre të pasurisë, të krijuar me kontribut monetar apo jo-monetar. Privimi prej saj, përmes tjetërsimit të pasurisë në formë të fshehjes, transferit apo shpenzimit të saj, padyshim përbën dhunë ekonomike dhe si e tillë nuk bën asses të lihet jashtë materies së ligjit të ri. Në këtë drejtim, Kosova mund të përfitoj shumë nga modelet e definimit gjithëpërfshirës të dhunës ekonomike në legjislacionet e vendeve të prezantuara në Kapitullin 3 të këtij hulumtimi. Në këtë drejtim, si më i përshtatshëm për kontekstin e Kosovës do të ishte definimi i dhënë në legjislacionin e Queensland në pikën 3.1 të këtij hulumtimi, si dhe definimi i përcaktuar me Aktin e Indisë për Mbrojtjen e Grave nga dhuna në familje, në pikën 3.3 të hulumtit. Kjo meqë të dy definimet përfshijnë, ndër të tjerash, edhe tjetërsimin e pasurisë një skenar mjaft i shpeshtë i dhunës ekonomike në vendin tonë.¹⁵⁸ Mbi të gjitha, drafti aktual i përgaditur me grupin punues të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, nuk e ka

përfshirë definimin e dhunës ekonomike të dërguar me shkrim që në fillim të punimeve nga vetë organizata jo-qeveritare që e ka inicuar ndryshimin e këtij ligji, INJECT. Sipas të gjeturave të këtij hulumtimi, propozimi i INJECT del të jetë tejet i përshtatshëm për kontekstin kosovar dhe është gjithëpërfshirës dhe i qartë, i lehtë për tu implementuar në praktikë gjyqësorë. Poashtu, është i krahasueshëm me legjislacionin të vendeve tjera, që e kanë definuar dhunën ekonomike.

4.4 Obligimet që rrjedhin nga Konventa e Stambollit

Me amandamentin Nr. 26 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Konventa e Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe dhunës shkurt Konventa e Stambollit, është bërë pjesë integrale e Kushtetutës. Për më tepër, Neni 22 i Kushtetutës përcakton se kjo Konventë tani gëzon zbatueshmëri direkte në Republikën e Kosovës. Nga kjo del se, gjatë hartimit të politikave dhe të legjislacionit, në këtë rast Ligjit të Ri për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës duhet të udhëhiqen nga obligimet që parashtrohen nga Konventa e Stambollit. Përndryshe, kjo konventë është instrumenti i parë i të drejtave të njeriut që në mënyrë shprehimore ka njohur dhunën ekonomike. Megjithatë, ajo ka dështuar të ofrojë një definimi të qartë të kësaj dhune. Gjithsesi, konventa përmban disa obligime me rëndësi që shtetet duhet ti aplikojnë kundrejt të gjitha formave të dhunës, përfshirë dhunën ekonomike.

Konventa me nenin 7(1), u krijon shteteve obligimin e ushimit të “kujdesit të duhur” për të “parandaluar, hetuar, dënua dhe ofruar reparacione për aktet e dhunës” nga akterët jo-shtetërorë/palët private.¹⁵⁹ Tutje, me nenin 12 të Konventës, parashihet obligimi i palëve kontraktuese për të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm ligjorë dhe masa të tjera për të parandaluar të gjitha format e dhunës të ushtruara nga një person fizik apo juridik. Ndërsa Neni 18 kërkon një bashkëpunim të ndërsjelltë mes akterëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë, të thirrur për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave nga të gjitha format e dhunës, me qëllimin final të arritjes së fuqizimit dhe pavarësisë ekonomike të viktimave të

158 INJECT, “Pasuria e përbashkët dhe mbajtja financiare” (2019), fq. 57.

159 Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, 12 Prill 2011, Neni, 7.1.

dhunës.¹⁶⁰ Pra, siç e konkretizon edhe Raporti Shpjegues i Konventës, shtetet jo vetëm që obligohen t'i ofrojnë viktimave siguri por edhe të ju mundësojnë atyre t'a rindërtojnë jetën përmes përkrahjes ekonomike.¹⁶¹

Së fundmi, obligimi për mbledhjen dhe mbajtjen e të dhënave gjithashtu derivon nga Konventa e Stambollit. Më konkretisht, nga shtetet pritet që të mbajnë një regjistër që përmban të gjitha rastet e formave të dhunës që mbulohen nga Konventa e Stambollit. Ky regjistër nuk duhet të limitohet vetëm në rast të ndjekjes dhe kallëzimeve penale, por është qenësore që të përfshihen edhe rastet e paraqitura pranë shtëpive të shëndetit, qendrave sociale si dhe pranë organizatave jo-qeveritare.¹⁶² Sipas Raportit Shpjegues të Konventës, një gjë e tillë është komponentë e domosdoshme e hartimit të politikave efektive. Në pak fjalë, të gjitha këto obligime duhet marrë parasysh gjatë nxjerrjes së Ligjit të ri për Mbrotjtjen nga Dhuna në Familje.

160 Po aty, Neni 18.3.

161 Raporti Sqarues i Konventës së Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, paragraf.32.

162 Po aty, paragrafët, 74-75.

5. Konkluzione dhe Rekomandime

Konkluzione

E drejta e njeriut në pronë është me rëndësi fundamentale, veçanërisht kur e njëjta shërben si bazë për realizimin e të drejtave të tjera. Ajo nuk limitohet në asetet ekzistuese, por përfshin edhe asetë të cilat një individ nuk i posedon, por për to ka pritshmëri legjitime. Po ashtu, prona konsiston edhe në padi, aktvendime në fazën e përmbarrimit, pensione e benefitet sociale. Një gjë e tillë është konfirmuar në një mori rastesh pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, vendimet e së cilës në bazë të Nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duhet të merren parasysh gjatë vendimmarrjes gjyqësore.

Përgjatë hulumtimit u theksua se e drejta në pronë implikon përpara shteteve obligime pozitive dhe negative që të njëjtën ta respektojnë, garantojnë dhe përmbushin. Këto obligime shtrihen edhe në veprimet e akterëve privatë që në të shumtën e rasteve janë abuzuesit kryesorë të së drejtës në pronë. Tipike ndër këto raste është edhe dhuna ekonomike e cila siç u përmend edhe më lartë atakon direkt financat e partnerit/es. Meqë e njëjta prekë në mënyrë disproporcionale gratë, hulumtimi u fokusua në ndikimin i këtij fenomeni në të drejtat pronësore të kësaj kategorie, që edhe ashtu mbetet shumë pak e përfaqësuar në pronësi.

Kështu, përgjatë hulumtimit u deklarua se abuzimi me financat përbën një ndër mënyrat më efektive të mbajtjes së partnerit të kurthuar në një marrëdhënie abuzive, si dhe ndër barrierat më të mëdha në sigurinë e personit pas largimit nga kjo marrëdhënie.¹⁶³ Ky abuzim, realizohet në një sërë formash, e më së shumti përmes mohimit të qasjes në para të nevojshme për nevoja personale e familjare, tjetërsimit të pasurisë gjatë dhe pas martesës si dhe, shmangies së obligimit të ushqimisë ndaj fëmijëve gjatë dhe pas divorcit. Tutje, hulumtimi dëshmoi së ndër shkaktarët kryesorë të dhunës ekonomike është mentaliteti i rrënjësor në shoqëri lidhur me “jo-përshtatshmërinë e gruas” për të gjeneruar dhe/apo mbajtur pasuri,” Përveç mentalitetit

edhe historia e mëparshme e dhunës në familje, niveli i ulët i shkollimit, kushtet e rënda ekonomike, thellojnë dhunën ekonomike. Pas kësaj, hulumtimi shqyrtoi praktikën e adresimit të dhunës ekonomike në shtetet e jashtme, përfshirë Tasmaninë, Queensland, Mbretërinë e Bashkuar dhe Indinë, si disa nga shtetet me modelet më të mira të normimit të dhunës ekonomike në legjislacion. Së fundmi, në mungesë të një definicioni konkret të dhunës ekonomike në Ligjin aktual për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, ky punim analizoi disa nga rrafshet aktuale të adresimit të dhunës ekonomike, në kuadër të Kodit Penal dhe Ligjit aktual për Mbrojtjen nga Dhuna Ekonomike, duke pasur parasysh gjithnjë se zgjidhja më e përshtatshme për trajtimin dhe ndëshkimin e dhunës ekonomike mbetet definimi i së njejtës me legjislacion. Një gjë e tillë i hap rrugë njohjes më të gjerë të dhunës ekonomike si të papranueshme, sanksionimit të saj dhe ofrimit të shërbimeve mbështetëse më efektive,¹⁶⁴ ndaj grave që i nënshtrohen kësaj forme të dhunës.

Rekomandime

I. Plotësim ndryshimi apo nxjerrja e një Ligji të ri për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje nuk toleron më tepër vonesa. Ky ligj ndër të tjerash duhet të adresojë:

a. Në Ligjin Aktual për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, dhuna ekonomike duhet të definohet më gjerë. Ky definim mund të realizohet në linjë me definimin e dhënë në legjislacionin e Queensland apo Indisë meqë të dy definicionet janë mjaft gjithpërfshirëse. Një gjë e tillë do të ishte shumë fitimprurëse nga aspekti i mbrojtjes së grave nga dhuna në familje, meqë përgjithësisht ligjet luajnë një rol të rëndësishëm, së paku me normimin e një sjelljeje të caktuar si të papranueshme. Po ashtu, ndëshkimet e parapara në ligj shpeshherë mund të shërbejnë si pengesë/frenim nga ndërmarrja e veprimit abuzues.

b. Për të qenë më i përgjegjshëm ndaj viktimave legjislacioni kundër dhunës në familje, e në këtë rast kundër dhunës ekonomike, duhet t'u sigurojë viktimave mbrojtje dhe qasje në shërbime mbështetëse.¹⁶⁵

163 Finacial Abuse Resource Centre, shih: <https://www.commbank.com.au/support/financial-abuse.html>.

164 Jeni Klugman, “Gender based violence and the law,” *Georgetown University*, (2017), fq. 1.

165 Jeni Klugman, “Gender based violence and the law,” *Georgetown University*, (2017), fq. 1.

c. Ligji duhet të njohë dhe ndëshkojë edhe dhunën ekonomike, gjatë dhe pas divorcit.

II. Vetëdijësimi i grave lidhur me të drejtat e tyre si dhe thjeshtësimi i procedurave gjyqësore, mund të inkurajojë më tepër inicime të padive si dhe reduktim të ashpërsimit të dhunës ekonomike.¹⁶⁶

III. Prokuroritë dhe Gjykatat duhet t'i trajtojnë me përkushtimin dhe seriozitetin e duhur paditë për dhunë ekonomike dhe të dënohen kryerësit e veprës sipas ligjit.

IV. Rekomandohet që Akademia e Drejtësisë të ofrojë për prokuroritë dhe gjykatat trajnime specifike për këtë temë.

V. Marrë parasysh rolin e madh që Organizatat Jo-Qeveritare mund të luajnë në parandalimin e dhunës ekonomike, të njëjtat duhet të marrin më tepër përgjegjësi për të ndihmuar gratë që ballafaqohen me dhunën në familje, përmes ngritjes së vetëdijes së grave rreth të drejtave të tyre si dhe trajnimit se si t'a dokumentojnë dhunën ekonomike.

VI. Përvec ngritjes së vetëdijes te gratë, Organizatat Jo-Qeveritare mund të jenë një ndër faktorët kyçë për parandalimin e dhunës ekonomike, përmes trajnimit të burrave rreth ndryshimit të qëndrimeve që kanë të bëjnë me rolin e gruas në familje. Në këto raste, OJQ-të duhet të mbjellin te burrat idenë mbi rolin e rëndësishëm të gruas në menaxhimin e burimeve financiare të familjes. Njëkohësisht, duhet të punohet në vetëdijësimin e burrave rreth efektit shkatërrues të dhunës ekonomike, në stabilitetin e familjes dhe shëndetin fizik e mendor të grave.¹⁶⁷

VII. Në bazë të hulumtimeve, në mes tjerash, rekomandohet edhe "këshillimi paramartesor," që konsiston në shërbime që ia mundësojnë grave, individualisht apo bashkërisht me partnerët e tyre, të iniciojnë diskutime rreth financave dhe vendimmarrjes financiare përpara se të hyjnë në lidhje më serioze apo të lidhin martesë.

VIII. Të krijohen linja ndihmëse telefonike për raportimin e dhunës ekonomike dhe marrjes së informatave të dobishme lidhur me parandalimin e dhunës ekonomike apo edhe shkëputjes nga lidhja abuzive.

IX. Të ipet prioritet ndërtimit dhe financimit të strehimoreve më afatgjata për viktimat e dhunës në familje, meqë strehimoret me mundësi qëndrimi për kohë të shkurtër nuk u lënë kohë të mjaftueshme viktimave që të marrin vetën dhe të fillojnë një kapitull të ri në jetën e tyre.

¹⁶⁶ Jinan Usta, Nisrine Makarem and Rima Habib, "Economic Abuse in Lebanon: Experiences and Perceptions," *American University of Beirut*, (2013), fq. 359.

¹⁶⁷ Po aty, fq. 372.

6. SHTOJCA 1.

Pyetësor për identifikimin e dhunës ekonomike

-
1. A ka ushtruar dhunë fizike ndaj jush kur keni diskutuar nevojën/dëshirën tuaj për të filluar punën?

 2. A ju ka kërcënuar në ndonjë formë tjetër me qëllim që ta lini punën?

 3. A ju ka vënë në atë pozitë që ju të detyroheni t'i kërkonit para?

 4. A ka marrë para nga kuleta apo llogaria juaj bankare, pa lejen/njohurinë tuaj?

 5. A ju ka detyruar t'i jepni para apo kredit-kartelën?

 6. A ju ka dirigjuar në shpenzimin e parave tuaja për një qëllim të caktuar, në vend se t'ju jap juve hapësirë për të vendosur?

 7. A ju ka kërkuar faturat/kuponat fiskalë si dëshmi të shpenzimit të mjeteve financiare?

 8. A ju ka privuar nga paratë e nevojshme për të mbuluar shpenzimet esenciale si ushqim e veshmbathje për ju dhe fëmijët tuaj?

 9. A ju ka fshehur paratë me qëllim që ju të mos i gjeni?

 10. A ka luajtur bixhoz me paratë tuaja?

 11. A ju ka kërkuar të huazoni para nga miqtë dhe familjarët tuaj dhe më pas nuk iu ka lejuar që ato t'ia ktheni?

 12. A ju ka huazuar para dhe më pas ka refuzuar t'ua kthej?

 13. A ju ka ndaluar qasjen në llogarinë tuaj bankare apo në atë të përbashkët?

 14. A ka marrë vendime të rëndësishme financiare pa u konsultuar fare me ju?

 15. A i ka shpenzuar për qëllime të tjera paratë e dedikuara për shpenzime shtëpiake si fatura të energjisë elektrike, higjencës dhe ujit?

 16. A ka refuzuar t'i paguajë faturat që janë në emër të përbashkët?

 17. A ka hyrë në borxh në emrin tuaj përmes kartelës suaj?

 18. A ka refuzuar të punësohet, duke ua lënë vetëm juve përgjegjësinë e mbajtjes së familjes?

 19. A ka lënë peng apo ndarë pasurinë tuaj me të tjerët?¹⁶⁸
-

168 Adriene Adams, Cris Sullivan, Deborah Bybee and Megan Greeson, *Development of the Scale of Economic Abuse*, Sage Publications, 2008, fq. 583.

7. Bibliografia

Legjislacioni i huaj

1. UK Parliament, Domestic Abuse Act 2021.
2. Këshilli i Bashkimit European, Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit European, 14 Dhjetor 2007.
3. Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat Themelore të Njeriut, 4 Nëntor 1950.
4. Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, 12 Prill 2011.
5. Organizata e Shteteve Amerikane, Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut, 22 Janar 1969.
6. Organizata e Unitetit Afrikan, Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve, 27 Qershor 1981.
7. The House of Lords (UK), Serious Crime Act, 2015.
8. Ministry of Law and Justice of India, New Delhi, The Protection of Women from Domestic Violence Act, 2005.

Legjislacioni vendor

9. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
10. Kodi Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës
11. Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.
12. Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-077.

Praktika Gjyqësore

1. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë*, 11 Janar 2007.
2. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Andrejeva kundër Letonisë*, 18 Shkurt 2009.
3. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Denisov kundër Ukrainës*, 19 Shtator 2018.
4. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Fedulov kundër Rusisë*, 8 Tetor 2019.
5. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Moskal kundër Polonisë*, 15 Shtator 2009.
6. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Nerva dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 15 Maj 1996.
7. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Oneryildiz kundër Turqisë*, 30 Nëntor 2004.
8. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës*, 20 Nëntor 1995.
9. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Pancenko kundër Letonisë*, 28 Tetor 1999.

10. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Raimondo kundër Italisë*, 22 Shkurt 1994.
11. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Stec dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 6 Korrik 2005.
12. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Stretch kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 24 Qershor 2003.

Të tjera

1. Adriene Adams, Cris Sullivan, Deborah Bybee and Megan Greeson, "Development of the Scale of Economic Abuse," *SAGE Publications*, (2008).
2. Amanda Mathisen, Judy Postmus, Sarah McMahon, "Measuring Abusive Behaviours: Is Economic Abuse a Unique form of abuse?" *Journal of Interpersonal Violence*, (2013).
3. Amanda Stylianou, "Economic Abuse Within Intimate Partner Violence: A Review of Literature," (2018).
4. Anna Lindskog, "The Indivisibility of Economic Violence in the Swedish Legal and Gender Equality Policy Discourse," *Umea University*, (2020).
5. Council of Europe, "Council of Europe Gender Equality Strategy 2018-2023," (2018).
6. Council of Europe Treaty Series, "Explanatory Report to the Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence," (2011).
7. Council of Europe, "GREVIO's (Baseline) Evaluation Report on legislative and other measures giving effect to the provisions of the Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence against Women and Domestic Violence," (2019).
8. Christophe Golay and Ioana Cismas, Legal Opinion: "The Right to Property from a Human Rights Perspective," *International Centre for Human Rights and Democratic Development & Geneva Academy of International Humanitarian Law and Human Rights*, (2010).
9. Cynthia Sanders, "Economic Abuse in the Lives of Women Abused by an Intimate Partner: A Qualitative Study," *Violence Against Women*, (2014).
10. Edith Bevin, Tasmanian man accused of preventing wife from making decisions, accessing joint accounts, (2016), shih: <https://www.abc.net.au/news/2016-08-01/tasmanian-man-prosecuted-for-alleged-economic-abuse/7679922>.
11. Emma Batha, "New UK law aims to end financial abuse in relationships. Can it work?" *Thomson Reuters Foundation*, (2021).
12. CommBank Support, "Financial abuse in the context of domestic and family violence."
13. Francesca Bettio and Elisa Ticci, "Violence Against Women and Economic Independence," (2017).
14. Get the Facts on Elder Abuse, (2021). Shih: <https://www.ncoa.org/article/get-the-facts-on-elder-abuse>.
15. Harvery M. Jacobs, "Private Property and Human Rights: A mismatch in the 21st century?" *International Journal of Social Welfare*, (2013).
16. Human Rights Watch, "Commentary on the Draft Law on Anti-Domestic Violence in Iraq," (2017).

17. INJECT, "Pasuria e përbashkët dhe mbajtja financiare" (2019).
18. "Inquiry into family, domestic and sexual violence, Submission 31," *Women's Legal Service Tasmania*, (2020).
19. Jeni Klugman, "Gender based violence and the law, World Development Report," *Georgetown University*.
20. Jelena Ristik, "Right to property: From Magna Carta to the European Convention on Human Rights," *Seeu Review*, (2015).
21. Jinan Usta, Nisrine Makarem and Rima Habib, "Economic Abuse in Lebanon: Experiences and Perceptions," *American University of Beirut*, (2013).
22. Judy Postmus, Kristina Nikolova, Hsiu-Fen Lin and Laura Johnson, "Women's Economic Abuse Experiences: Results from the UN Multi-Country Study on Men and Women in Asia and the Pacific," *Journal of Interpersonal Violence*, (2021).
23. Karni Krigel and Orly Benjamin, "From Physical Violence to Intensified Economic Abuse: Transitions between the type of IPV Over Survivors' Life Courses," (2020).
24. Karol Boudreaux, "Empowering the poor through property rights," *Commission on Legal Empowerment of the Poor, United Nations Development Programme, Neë York*, (2008).
25. Marilyn McMahon and Paul Mcgoerry, "Criminalizing emotional abuse, intimidation and economic abuse in the context of family violence: The Tasmanian experience," *University of Tasmania Law Review*, (2017).
26. Nevena Petrusic, Natasa Todorovic, Milutin Vracevic and Brankica Jankovic, "Financial Abuse of Older Women in Serbia," *Journal of Elder Abuse and Neglect*, (2015).
27. Omer Alkan, Senay Ozar and Seyda Unver, "Economic violence against women: A case in Turkey," *PLoS ONE*, (2021).
28. Olufunmilyao Fawole, "Economic Violence to Women and Girls: Is it receiving the necessary attention?" *University College Hospital, Ibadan, Nigeria*, (2008).
29. Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), "Pilot Indeksi për të Drejtat Pronësore të Grave," *QKSGJ*, (2020).
30. Richard Gelles, "Violence in the Family: A Review of Research in the Seventies," *National Council on Family Relations*, (1980).
31. Sentencing Advisory Council, "Sentencing of Adult Family Violence Offenders Final Report No. 5," *Tasmania*, (2015).
32. Sundari Anitha, Understanding Economic Abuse Through an Intersectional Lens: Financial Abuse, Control and Exploitation of Women's Productive and Reproductive Labor.
33. Taner Akar et al. "The prevalence of domestic violence against women among a group of women: Ankara, Turkey," *Journal of Family Violence*, (2010).
34. The Co-operative Bank, "My Money, My Life: A financial guide for victims of domestic violence," *Refuge*, (2008).

Tatjana Duric Kuzmanovic, Ana Pajvancic-Cizelj, "Economic violence against Women: Testimonies from the

Women's Court in Sarajevo," *European Journal of Women Studies*, (2020).

35. Truchero, "Economic violence, a form of domestic violence," (2013).
36. United Nations, Department of Economic and Social Affairs, Division for the Advancement of Women, 2009 Survey on the Role of Women in Development, Women's Control over Economic Resources and Access to Financial Resources, including Microfinance, UN, (2009).
37. UNSW Australia, "Responding to Economic Abuse." Shih: https://www.arts.unsw.edu.au/sites/default/files/documents/Issues_paper_2__Responding_to_economic_abuse.pdf.
38. World Bank Blogs, "No, 70% of the world's poor aren't women, but that doesn't mean overtly isn't sexist," (2018), shih: <https://blogs.worldbank.org/developmenttalk/no-70-world-s-poor-aren-t-women-doesn-t-mean-poverty-isn-t-sexist>.

